

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5613
E shtunë, 27 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Njazi Thaçi zgjedhet drejtor i KEK-ut

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

SI TË MBROHET KOSOVA NGA VETË KOSOVARËT?

F. 12

Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



THAÇI: NË FRANCË NUK DO TË KETË DIALOG NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

F. 5

PAS TRI VJET PRITJESH, OKUK-JA BËHET ME ANGIOGRAFI

F. 6

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS ZGJEDH SOT MYFTIUN E RI

F. 7

EKONOMI

QEVERIA MIRATON PROJEKTBUKSHETIN PËR VITIN 2019

F. 9

ALIU: ÇMIMIN E LARTË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PO E PAGUAJMË ME PYJET E KOSOVËS

F. 8

KULTURË

NJË MONUMENT PËR DERVISH SHAQEN

F. 13

Prof. Ymer GASHI

POEZIA MEDITATIVE DHE MILITARE E ARIF MOLLIQIT

F. 13

B. ARMAGEDONI



FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI

FAQE 4-5

Së pari konsensusi për dialog, pastaj zgjedhjet

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka kundërshtuar qëndrimin e LDK-së dhe të LV-së, të cilat po kërkojnë zgjedhje të reja para se të flitet për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka bërë me dije se fillimisht duhet të arrihet një konsensus kombëtar në mes të pozitës dhe opozitës për dialogun me Serbinë, pastaj të bisedohet për zgjedhje

të reja. Ai ka shprehur optimizëm se pozita dhe opozita do të mund të gjejnë një gjuhë të përbashkët për këtë çështje. Sipas Sherifit, nuk do të ishte mirë të shkohet në dialog me Serbinë pas konsensus kombëtar

Zgjedhjet e shpeshta kanë pamundësuar përfundimin e reformës zgjedhore

Republika e Kosovës është shteti që më së shpeshti ka organizuar zgjedhje, por më së paku ka përkushtim për reformë zgjedhore. Kështu është thënë të premtën nga të pranishmit në konferencën "Sfidat dhe praktikat rajonale për reformimin e sistemit zgjedhor". Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, drejtori i KDI-së, Ismet Kryeziu, dhe ambasadori i OSBE-së, Jan Braathu, kanë vlerësuar se reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet shtetëror

FAQE 3



Kosova, mundësi të shumta për investitorët e huaj

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shtëpia e Bardhë fton Putinin në Uashington

UASHINGTON, 26 TETOR - Shtëpia e Bardhë ka ftuar zyrtarisht presidentin rus Vladimir Putin në Uashington, ka njoftuar të premten këshilltari i Sigurisë Kombëtare John Bolton.

"Ne e kemi ftuar presidentin Putin në Uashington", tha Boltoni në një konferencë me

gazetarë gjatë një vizite në Gjeorgji, pak ditë pas takimit me Putinin dhe zyrtarë të lartë të sigurisë në Moskë.

Ai tha se gjatë vizitës në Moskë i kishte dhënë presidentit Putin një ftesë për të vizituar Uashingtonin vitin e ardhshëm, sipas Radios Evropa e Lirë.

Nuk është ende e qartë nëse Putini e ka pranuar ftesën. Takimi i tij i fundit me një president të ShBA-së në tokën amerikane ka qenë ai me presidentin Barak Obama në vitin 2015 gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork.

Një ftesë e mëparshme e presidentit Trump për Putinin u prit me kundërshtime në Uashington duke përfshirë edhe nga ligjvënës të Partisë Republikane, të cilët argumentuan se presidenti rus ishte një kundërshtar jo i denjë për të vizituar Shtëpinë e Bardhë.



Meta: Shkëmbimi i terri-toreve shkatërron sigurinë

Presidenti Meta në ligjëratën e mbajtur në Qendrën "Xhorxh Marshall" të Gjermanisë tha se kërkimi i normalizimit të marrëdhënieve nëpërmjet shkëmbimit të terri-toreve do të thotë të shkatërrosh e të çosh dëm një investim sigurie prej dy dekadash, duke cekur se si ambiciet politike që u përpoqën të krijojnë shtete etnike homogjene në Ballkan, prodhuan tragjedi të tmerrshme njerëzore



BERLIN, 26 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka vizituar Qendrën Evropiane të Sigurisë "Xhorxh Marshall" në Garmish të Gjermanisë, për të folur për çështjet e sigurisë dhe integritetin euro-atlantik të Ballkanit.

Kreu i shtetit shqiptar, Meta, gjatë ligjëratës së tij theksoi se zgjerimi i NATO-s dhe kompaktësia e Bashkimit Evropian kundërshtojnë rajonit të Ballkanit Perëndimor mbeten kyç për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit të Ballkanit.

"Ne jemi të interesuar për një rajon të paqte, të qëndrueshëm dhe të sigurt, të ankoruar plotësisht në NATO si dhe të integruar në Bashkimin Evropian. Duam të shohim një rajon që zhvillohet më tej dhe që përparon, në marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe që u përgjigjet qytetarëve të vet në secilën prej 6 vendeve", tha ai.

Presidenti Meta ka thënë se

Shqipëria dhe shqiptarët kanë demonstruar një prirje të vendosur civile dhe politike për t'u bashkuar me NATO-n dhe BE-në, si garantuesit më të besueshëm për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit. Me këtë rast ai theksoi se shqiptarët në Malin e Zi ishin një faktor përcaktues në miratimin e pranim-it në NATO, si dhe referendumi në Maqedoni dëshmoi se shqiptarët ishin kompaktë në votim pro Marrëveshjes së Prespës dhe rrjedhimisht, në favor të hapjes së perspektivave të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Gjatë kësaj ligjërate, presidenti i Shqipërisë shprehu qartë kundërshtinë e tij rreth propozimit të fundit për një debat të ri mbi atë që do të përbënte "marrëveshjen përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë", i cili po konsumon shumë energji për objektivat e

gabuar".

"Debati as nuk e konsolidon dhe as nuk e paqton rajonin", tha presidenti.

Ai theksoi se kjo retorikë politike po zhvillohet me një gjuhë të ashpër provokuese, duke ringjallur "nostaljinë" e regjimit të tmerrshëm të gjenocidit.

"Hapja e një debati të tillë në një kohë kur janë ngritur flamujt e kuq sinjalizues e paralajmëruet nga SHBA-ja dhe BE-ja, për përfshirjen e aktorëve të tretë në rajon, e bën atë edhe më alarmues", ka deklaruar Meta.

Presidenti nënvizoi se "kërkimi i normalizimit të marrëdhënieve

nëpërmjet shkëmbimit të terri-toreve do të thotë të shkatërrosh e të çosh dëm një investim sigurie prej dy dekadash", duke risjellë në vëmendje "se si ambiciet politike që u përpoqën të krijojnë shtete etnike homogjene në Ballkan, prodhuan tragjedi të tmerrshme njerëzore", me mijëra viktima dhe persona të zhdukur, dhjetëra mijëra njerëz të zhvendosur forcërisht, që ishin pasojat e gjenocidit të Millosheviqit.

Meta ua përkujtoi pjesëmarrësve në ligjëratën e tij se kjo çoi në angazhimin e parë ushtarak të Aleancës Perëndimore në his-

torinë e saj pesëdhjetëvjeçare dhe se "ndërhyrja vendimtare e NATO-s në Kosovë, krijoi një ekuilibër të ri në marrëdhëniet ndërmjet Ballkanit dhe Perëndimit".

"Që prej atëherë, ky rajon është përfshirë në zotërimin e tyre të sigurisë si e vetmja antidotë për të pasur e gëzuar paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm", ka shtuar Meta.

Presidenti Meta ka thënë se modeli evropian i bashkëjetesës është i vetmi kusht i domosdoshëm për të ardhmen e Ballkanit dhe perspektivën e tij evropiane.

Qeveria e Shqipërisë mblidhet në Kukës

TIRANË, 26 TETOR - Kryeministri Edi Rama ka zgjedhur që këtë fundjavë ta mblidhë qeverinë në Kukës. Këto dy ditë ministrat dhe Rama do të inspektojnë punimet e dy urave në rrugën Kukës-Morinë, ashtu si edhe pikën doganore të Morinës. Një diskutim për lojërat e fatit, Rama e ka rezervuar me gratë e vajzat kuksiane.

Qeveria do të mblidhet këtë fundjavë në Kukës. Sipas axhendës së publikuar, kryemi-

nistri Edi Rama e ministrat do të ndalen së pari në Shishtavec në një takim me banorët për projektin "100 fshatrat".

Pas një dreke në Novoselë, kreu i qeverisë do t'i inspektojë punimet për ndërtimin e dy urave nga ARRSH në rrugën Kukës-Morinë.

Më pas do të inspektohet edhe pika doganore e Morinës, pikë e përbashkët kjo me Kosovën.

Pasditë, kryeministri Rama do të marrë pjesë në takimin me të

rinjtë e qarkut në Pallatin e Kulturës "E gjithë vëmendja për ju", ku do të bëhen anëtarësime të reja.

Në fund, ministra e zëvendësministra do të jenë pjesë e një feste me të rinjtë, ku duket se kryeministri nuk do të jetë i pranishëm.

Sot (e shtunë), kryeministri do të jetë në shtëpinë e një familjeje që po rindërtohet. Më pas kreu i qeverisë do të inspektojë spitalin rajonal të Kukësit,



repartin e Mamografisë. Rama ka vendosur të diskutojë

me gratë e vajzat e Kukësit edhe Ligjin për mbylljen e basteve.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur konferencën rajonale me temë "Sfidat dhe praktikat rajonale për reformimin e sistemit zgjedhor"

Zgjedhjet e shpeshta kanë pamundësuar përfundimin e reformës zgjedhore

Republika e Kosovës është shteti që më së shpeshti ka organizuar zgjedhje, por më së paku ka përkushtim për reformë zgjedhore. Kështu është thënë të premten nga të pranishmit në konferencën "Sfidat dhe praktikat rajonale për reformimin e sistemit zgjedhor". Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, drejtori i KDI-së, Ismet Kryeziu, dhe ambasadori i OSBE-së, Jan Braathu, kanë vlerësuar se reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet shtetëror

lik rreth nevojave dhe specifikave që duhet të përfshijë reforma zgjedhore. Njëkohësisht janë analizuar në detaje shkaktarët e numrit të madh të votave të pavlefshme. Po ashtu, kemi tentuar të sjellim një model të përshtatshëm të fletëvotimit që do të kontribuonte në uljen e numrit të votave të pavlefshme", ka deklaruar Kryeziu, duke shtuar se në Kuvendin e Kosovës është një draft shumë i mirë i punuar për reformën zgjedhore. "Kemi punuar për reformimin e sistemit zgjedhor nga viti 2010 deri në vitin 2013. Kujtoj se nga viti 2014 janë përfshirë dhe aktorë të tjerë në këtë çështje, si nga grupet parlamentare punuese, shoqëria civile, e organizata ndërkombëtare", ka theksuar ai.

Ndërsa kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë të premten se reforma zgjedhore duhet të ndodhë sa më shpejt dhe nuk duhet të pritet më gjatë. Ajo ka

thënë se reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i institucioneve të shtetit. Sipas Dakës, KQZ-ja është e gatshme ta japë kontributin e vet profesional në aspektin teknik zgjedhor. "Reforma zgjedhore që ka filluar para disa vjetësh duhet të ndodhë dhe nuk duhet të presim më shumë vite që ta përfundojmë atë. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje çdo sfide dhe mënyra më e mirë është përmes reformës zgjedhore. Reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i institucioneve të shtetit tonë. Shpresojmë këtë ta dëgjojnë edhe ata që janë përgjegjës për reformën zgjedhore. KQZ-ja është e gatshme që ta japë kontributin e vet profesional në aspektin teknik zgjedhor", ka thënë Daka.

Ajo ka theksuar se reforma zgjedhore duhet t'i nënshtrohet së pari votimit me kusht, emërimit të anëtarëve të këshillave të vendotimeve, mënyrës së numërimit të fletëvotimeve si dhe shumë çështje të tjera të cilat mund të debato-

hen gjatë reformës. "Reforma zgjedhore duhet ta sigurojë integritetin e zgjedhjeve të ardhshme sepse vetëm kështu mund të sigurojmë zgjedhje të lira dhe demokratike", ka deklaruar Daka. Kurse ambasadori i misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu, ka vlerësuar se është në interes të të gjithëve që sistemi zgjedhor të jetë i lirë dhe i drejtë. Ai ka theksuar se është përgjegjësi e Qeverisë dhe Kuvendit për të siguruar që procesi zgjedhor të jetë jo vetëm i drejtë, por të ketë edhe integritet. "Është në interes të të gjithëve që sistemi zgjedhor të jetë i lirë dhe i drejtë. Ka të bëjë me legjitimitetin e institucionit dhe përfaqësimin më të denjë. Integriteti është çelësi për legjitimitetin e të gjithë procesit zgjedhor. Është përgjegjësi e Qeverisë dhe Kuvendit për të siguruar që procesi zgjedhor të jetë jo vetëm i drejtë, por të ketë edhe integritet", është shprehur Braathu.

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të premten ka mbajtur konferencën rajonale me temë "Sfidat dhe praktikat rajonale në reformimin e sistemit zgjedhor". Me këtë rast, drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se Kosova është shteti që më së shpeshti ka organizuar zgjedhje, por më së paku ka përkushtim për reformë zgjedhore. Ai ka vlerësuar se

zgjedhjet e shpeshta në dhjetë vjetët e fundit po e pengojnë reformimin e sistemit zgjedhor. "Kosova është shteti që më së shpeshti organizon zgjedhje, por më së paku ka përkushtim për reformë zgjedhore. KDI-ja së bashku me organizatat e shoqërisë civile ka arritur të ndërtojë qëndrime të përbashkëta lidhur me disa segmente të rëndësishme të reformës zgjedhore dhe janë zhvilluar takime me subjektet politike për t'i parë nga afër preferencat e tyre për reformë. Janë bërë matje të opinionit pub-



Haradinaj: Pajtim me Serbinë, por jo ndryshim kufijsh

PRISHTINË, 26 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur edhe një herë qëndrimin se nuk pranon ndonjë marrëveshje me Serbinë që çon drejt ndryshimit të kufijve. Në një konferencë për media pas

mbledhjes së Qeverisë, Haradinaj ka thënë se "mund të ketë marrëveshje ligjore për një-hje reciproke me Serbinë, por jo marrëveshje të bazuar në territor as në kufi". "Ato janë kamuflazh për ndarje të Kosovës. Kosova

është ajo e 17 shkurtit të 2008-s", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka bërë me dije se Kosova është e interesuar për pajtim me Serbinë në mënyrë që të mbyllet çështjet e hapura në rajon.



Flet për "Epokën e re", Bilall Sherifi

Së pari konsensusi për dialog, pa



Shefi i Grupit Parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka kundërshtuar qëndrimin e LDK-së dhe të LV-së, të cilat po kërkojnë zgjedhje të reja para se të flitet për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka bërë me dije se fillimisht duhet të arrihet një konsensus kombëtar në mes të pozitës dhe opozitës për dialogun me Serbinë, tek pastaj të bisedohet për zgjedhje të reja. Ai ka shprehur optimizëm se pozita dhe opozita do të mund të gjejnë një gjuhë të përbashkët për këtë çështje. Sipas Sherifit, nuk do të ishte mirë të shkohet në dialog me Serbinë pa konsensus kombëtar

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË 26 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka deklaruar që së pari pozita dhe opozita duhet të gjejnë një konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë, pastaj të flasim për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se fakti që ende nuk është arritur një marrëveshje në mes të pozitës dhe opozitës për të ashtuquajturën fazë të fundit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është një lajm i mirë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka shprehur optimizëm që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje.

"Aktualisht kemi një situatë ku dy partitë opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, kanë dalë me kërkesën zgjedhje para dialogut përderisa ne mendojmë se renditja duhet të jetë ndryshe, së pari dialogu, pastaj zgjedhjet. Kjo tash për tash e bën më të vështirë arritjen e një konsensusi. Megjithatë, shpresoj që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje e cila shkon përtej interesave partiake", ka thënë Sherifi. Ai ka deklaruar se do të ishte mirë që të mos shkohet në fazën përfundimtare të dialogut pa konsensus në mes të pozitës dhe opozitës. "Nuk mendoj se do të ishte mirë që të hyjmë në proces pa e arritur konsensusin e gjerë në mes të partive të pozitës dhe të opozitës", është

shprehur Sherifi.

Shefi i grupit parlamentar i Nismës ka folur edhe për paralajmërimet e opozitës për rrëzim të Qeverisë me anë të mocionit të mosbesimit. Sipas tij, pretendimi i opozitës, se kuvendi aktual nuk ka legjitimitet, nuk qëndron. "Në fillim dua të nënvizoj se opozita në çdo kohë ka të drejtë të kërkojë zgjedhje të parakohshme. Këtë të drejtë nuk mund t'ia mohojë askush. Sa i përket legjitimitetit të Qeverisë, mendoj se nuk kanë të drejtë, sepse si çdo Qeveri, edhe kjo Qeveri legjitimitetin e ka marrë nga votimi i shumicës deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Rrjedhimisht derisa Kuvendi nuk vendos ndryshe, qoftë përmes mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, qoftë

staj zgjedhjet

"Epoka e re": Braktisjen e Kuvendit këto dy subjekte opozitare po e arsyetojnë duke thënë se ky institucion ka humbur legjitimitetin. Madje LDK-ja dhe LV-ja kanë paralajmëruar rrëzimin e Qeverisë, në mënyrë që të shkohet në zgjedhje të reja. Sa ka gjasa të ndodhë kjo?

Sherifi: Në fillim dua të nënvizoj se opozita në çdo kohë ka të drejtë të kërkojë zgjedhje të parakohshme. Këtë të drejtë nuk mund t'ia mohojë askush. Sa i përket legjitimitetit të Qeverisë, mendoj se nuk kanë të drejtë, sepse si çdo qeveri, edhe kjo Qeveri legjitimitetin e ka marrë nga votimi i shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Rrjedhimisht, derisa Kuvendi nuk vendos ndryshe, qoftë përmes mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, qoftë përmes vetëshpërndarjes së Kuvendit, konstatimi i dy partive opozitare, se Qeveria nuk ka legjitimitet, nuk qëndron!

"Epoka e re": Pavarësisht prej përpjekjeve të shumta, pozita dhe opozita nuk po mund ta gjejnë një gjuhë të përbashkët për dialogun me Serbinë. Projektrezoluta e PSD-së për dialogun Kosovë - Serbi nuk është votuar në Kuvend, sikurse nuk është votuar as ajo e LDK-së dhe as ekipi negociator i Qeverisë për dialogun me Serbinë. A ka ende gjasa për konsensus rreth kësaj çështje?

Sherifi: Fakti që ende nuk është arritur një marrëveshje në mes të pozitës dhe opozitës për të ashtuquajturën fazë të fundit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është një lajm i mirë. Aktualisht kemi një situatë ku dy partitë opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, kanë dalë me kërkesën zgjedhje para dialogut përdorur në mendimet se renditja duhet të jetë ndryshe, së pari dialogu, pastaj zgjedhjet. Kjo tash për tash e bën më të vështirë arritjen e një konsensusi. Megjithatë, shpresoj që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje e cila shkon përtej interesave partiake.

"Epoka e re": Lideri i Nismës Socialdemokrate, z. Limaj, ka deklaruar së fundi se shumë shpejt pritet të votohet në Kuvend ekipi negociator i Qeverisë për bisedime me Serbinë. Si do të arrihet kjo?

Sherifi: Shpresoj që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje e cila shkon përtej interesave partiake.

Thaçi: Në Francë nuk do të ketë dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 26 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Kosova do të përfaqësohet nga liderët e saj në çdo takim ndërkombëtar ku merr pjesë për pjesëmarrje, pa marrë parasysh mospajtimet e Serbisë. Këto komente Thaçi i bëri në Forumin Frankofon të Investimeve që po mbahet në Prishtinë, konferencë që bashkon kompani të ndryshme nga vendet frankofone për ta diskutuar bashkëpunimin ekonomik.

Presidenti francez Emmanuel Macron më 11 nëntor do të jetë nikoqir i shumë liderëve botërorë, në manifestimin e përvjetorit të 100 të përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Kosova do të përfaqësohet nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili theksoi se çdo

mundësi e pjesëmarrjes jashtë vendit do të shfrytëzohet për ta promovuar vendin dhe siguruar njohje. "Kosova me liderët e saj do të marrë pjesë kudo që është e ftuar, me mesazhet më të mira të paqes, pajtimit, të perspektivës së Kosovës për NATO dhe Bashkim Evropian. Liderët aty janë të ftuar prej presidentit francez Macron dhe të gjithë ata që janë aty do të kenë mundësi të shihen me njëri-tjetrin, por një gjë e them, atje nuk do të ketë dialog Kosovë - Serbi, por do të jetë një mundësi e afirmimit të shtetit të Kosovës. Edhe pjesëmarrja e presidentit të Serbisë është nën autoritetin e presidentit francez dhe jo të Kosovës. Serbia mund të ketë vërejtje në këtë drejtim, por është punë e tyre", ka thënë

Thaçi.

Ai, po ashtu, bëri thirrje për unitet në Kuvendin e Kosovës, për ta zgjidhur çështjen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes një platforme të përbashkët. "Sa i përket dialogut, besoj se Kuvendi duhet t'i kryejë punët e veta, duhet të tejkalohet dhe ftoj spektrin politik të Kosovës, pa dallim, ata që janë në Qeveri dhe ata në opozitë, ta tejkalojnë këtë ngërç politik dhe institucional dhe t'i hapin perspektivë vendit. Presidenti do t'i kryejë punët e veta, ndërsa ftoj spektrin politik t'i marrë përgjegjësitë e veta që i takojnë, që të ofrohen sa më tepër, të kenë një platformë të përbashkët shtetërore", ka deklaruar presidenti Thaçi.



përmes vetëshpërndarjes së Kuvendit, konstatimi i dy partive opozitare, se Qeveria nuk ka legjitimitet, nuk qëndron!", ka thënë Sherifi.

"Epoka e re": Deputetët e LDK-së dhe të LV-së, pas votimeve të disa projektligjeve, sërish braktisën seancën e të enjtes. Cili është komenti juaj ndaj veprimeve të këtyre dy partive?

Sherifi: Dalja e deputetëve të dy partive të opozitës, LDK-së dhe LV-së nga seanca e sotme, është një veprim politik në kuadër të vendimit të tyre për t'i bojkotuar seancat e Kuvendit. Arsyet për një veprim të tillë, qoftë të arsyeshme qoftë të paarsyeshme, ata i kanë bërë publike dhe unë nuk dua t'i komentoj.

Pas tri vjet pritjesh, QKUK-ja bëhet me angiografi

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se pas tri vjetësh pritje, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) është bërë me angiografi. "Jam shumë i lumtur që sot në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës kemi arritur ta sjellim angiografinë e ri nga Austria. Është për keqardhje

që për shkak të keqmenaxhimeve të këtij sektori, angiografi në vlerë prej 2.1 milionë eurosh, i blerë nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2015 me paratë e qytetarëve tanë, është vonuar kaq gjatë. Si pasojë, mijëra pacientëve kosovarë u është mohuar shërbimi cilësor shëndetësor dhe në Kardiologjinë Invazive janë kri-

juar lista të gjata të pritjes. Sidoqoftë, ne nuk kemi zgjedhur rrugën e ankesave, të baltosjes e as të hedhjes së fajit. Ne kemi zgjedhur që të bëjmë reforma, edhe nëse kjo nënkupton rregullim të keqmenaxhimeve të së kaluarës. Urime!", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".



Klinika e ORL-së në QKUK i shpëton jetën fëmijës 17 muajsh



EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 TETOR - Ekipi mjekësor i Klinikës së Otorinolaringologjisë (ORL) ka shpëtuar jetën e fëmijës E. R. (2017), i cili me autoambulancë në gjendje të rënduar ishte sjellë nga Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj si pasojë e përtpjes së kikirikëve. "Në pranim, mjeku kujdestar i klinikës konstaton gjendjen e rëndë të fëmijës dhe bën përgatitjen urgjente për ta futur në sallë, duke kompletuar

fëmijën me analiza dhe konsulta pediatrike si dhe nga ana e anesteziologut. Konstatohet gjendje e rënduar e fëmijës, e bazuar në ekzaminim dhe radiografi të kraharorit, konstatohet se njëri krah mushkëror ishte jashtë funksionit. Duke qenë se ka më shumë përvojë dhe është i përgatitur për të tilla raste, thirrret drejtori i klinikës, i cili, bashkë me ekipin kujdestar të anesteziologjisë, realizojnë bronkoskopinë rigjide, heqjen e farës së kikirikut nga mushkëritë (bronku i majtë). Procedura kaloi pa kom-

plikime dhe fëmija gëzon shëndet të mirë", është bërë me dije në njoftimin për media të QKUK-së. Pas radiografisë kontrolluese, shihet se është bërë rifunksionalizimi i mushkërive. Fëmija pas këtij tretmani është lëshuar në shtëpi. Sipas deklarimeve të prindërve, fëmija ka qenë në shtëpi dhe, derisa ata po pinin çaj, ai ka marrë një farë kikiriku dhe e ka futur në gojë, pastaj atë e ka tërhequr rryma ajrore në mushkëri (bronke) dhe fëmija ka përjetuar situatë të rëndë dhe është shoqëruar me cianoze (nxirje).



Kosova dhe Serbia arrijnë marrëveshje për personat e pagjetur

PRISHTINË, 26 TETOR - Delegacionet e Kosovës dhe të Serbisë miratuan procedurat për pranim-dorëzimin e mbetjeve mortore, që mund të ndihmojnë në kërkimin e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.

Marrëveshja u arrit nga Grupi Punues për Persona të Zhdukur dhe u bë me dije pas takimit të delegacioneve të Serbisë, Kosovës dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Beograd. Delegacionet pjesëmarrëse, të

udhëhequra nga Velko Odalioviq, Ibrahim Makolli dhe Fabienne Bourdieu, thanë se presin që procedurat e miratuara ta ndihmojnë procesin e gjetjes së të zhdukurve. "Sot, 20 vjet pas luftës, 6 057 njerëz janë të raportuar në

Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq si të zhdukur nga konflikti në Kosovë", ka thënë Bourdieu, duke shtuar se "familjet e tyre jetojnë në pasiguri, pa e ditur se çfarë ka ndodhur me të dashurit e tyre".

Sipas të dhënave të organizatës joqeveritare "Fondi për të Drejtën Humanitare" nga lufta në Kosovë më 1998-99, mbeten të zhdukur 1 658 persona. Prej tyre, mbi 1 000 janë shqiptarë, ndërsa mbi 500 janë serbë dhe të tjerë.

Mbahet Forumi i Frankofonisë në Prishtinë i cili ka mbledhur shumë përfaqësues të bizneseve ndërkombëtare nga hapësira frankofone

Kosova me mundësi të shumta për investitorët e huaj

Ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka thënë se Kosova tash e dhjetë vjet ka arritur të krijojë një kornizë të përshtatshme për investime, me një sistem fiskal që është efikas dhe tërheqës për ndërmarrje. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi ka theksuar se Kosova është shtet i ri, me mundësi të mëdha dhe legjislacion të standardeve më të larta evropiane, ku ka shumë mundësi investimi për investitorët ndërkombëtarë

mundësi do të jetë një shtytje e madhe edhe për afaristët e tjerë që të vijnë në Republikën e Kosovës, t'i shikojnë të gjitha mundësitë e investimeve. Disa prej jush veç kenë filluar dhe kenë pasur sukses, disa jeni në procese të këtyre sukseseve", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar Francën dhe presidentin Macron për mbështetjen që i kanë dhënë Kosovës në dy dekadat e fundit. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë në këtë forum. Ai ka falënderuar organizatorët për këtë forum duke thënë se afaristët e respektuar janë më meritoret që na bënë bashkë sot në këtë ngjarje, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit ekonomik dhe klimën e mirë të investimeve në Kosovë, për të cilat tha se janë politika të favorshme të dedikuara investimeve dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Më tej, kryeministri Haradinaj ka përmendur edhe politikat

tatimore dhe lehtësirat për fillimin e një ndërmarrje të re në Kosovë, po ashtu edhe infrastrukturën e mirë për biznese. Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar pozitën e volitshme gjeografike të Kosovës, duke thënë se nëse dëshiron të kesh biznes, janë dy orë nga të gjitha qendrat në rajon, që është një përparësi ndaj ekonomive edhe të vendeve të rajonit.

Haradinaj ka potencuar se Kosova është e hapur për investime të huaja, duke marrë si shembull të mirë, model të zhvillimit të biznesit dhe dëshmi të suksesit, kompanitë franceze që veprojnë në Kosovë, duke inkurajuar investitorët edhe për faktin se tani sistemi gjyqësor në Kosovë është përmirësuar, është forcuar rendi dhe ligji e, po ashtu, vendi ka fuqi punëtore të kualifikuar dhe të gatshme për tregun e punës. Duke folur për liberalizimin e vizave, kryeministri Haradinaj ka theksuar vështirësitë që kanë qytetarët dhe ndërmarrësit për zhvillim-

in e partneritetit me ekonomitë franceze, vendet frankofone dhe ato të Evropës derisa ekziston regjimi i vizave. Ndërkaq ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka thënë se Kosova tash e dhjetë vjet ka arritur të krijojë një kornizë të përshtatshme për investime, me një sistem fiskal që është efikas dhe tërheqës për ndërmarrje, me fuqi të re punëtore, 50 për qind e popullsisë është më e re se 30 vjet, dhe kjo tregon për një frymë të fortë sipërmarrëse. Sipas ambasadorit Chabert, ky forum tregon se ka investitorë seriozë që janë të interesuar për Kosovën.

Ministri i Financave, Bedri Hamza dhe ai i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, vlerësuan ambientin e mirë të të bërit biznes dhe lehtësirat fiskale që janë në favor të zhvillimit të sektorit privat në Kosovë, duke u bërë thirrje investitorëve nga vendet frankofone që kapitalin e tyre ta investojnë në Kosovë.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në Forumin e Frankofonisë, i cili të premtën në Prishtinë ka mbledhur shumë përfaqësues të bizneseve ndërkombëtare nga hapësira frankofone. Presidenti Thaçi në këtë forum ka thënë se Kosova është shtet i ri, me mundësi të mëdha dhe legjislacion të standardeve më të larta evropiane, ku ka shumë mundësi investimi për investitorët ndërkombëtarë.

"Ky takim sot është një mundësi e re, e pashfrytëzuar deri më tani për investitorët dhe afaristët e huaj. Këtu në sallë sot shoh njerëz të suksesit, njerëz të punës, njerëz që kanë pasur sukses edhe në vende të tjera të rajonit, por edhe më gjerë, që janë shembull i suksesit në botë", ka thënë Thaçi.

Sipas kreut të shtetit, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës do t'u dalin në ndihmë investitorëve ndërkombëtarë, derisa forumi është një mundësi e cila duhet të shfrytëzohet maksimalisht. "Kjo



Bashkësia Islame e Kosovës zgjedh sot myftiun e ri

PRISHTINË, 26 TETOR - Sot (e shtunë) do të zgjidhet kryetari i ri i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Procesi i zgjedhjes së myftiut të ri do të fillojë në orën 9:00.

Kandidaturat zyrtare për këtë pozitë nuk janë bërë publike. "Radio Evropa e Lirë" merr vesh se kandidatë janë myftiu i deritanishëm, Naim Tërnavë, dhe

zëvendësi i tij, Reshat Mexhiti. I kontaktuar nga "Radio Evropa e Lirë", Reshat Mexhiti, i cili aktualisht është imam në xhaminë Bajrakli në Prizren, ka thënë shkurt se nuk mund të flasë për këtë çështje. "Nesër janë zgjedhjet dhe në respekt të qetësisë dhe heshtjes nuk komunikojmë. Mund t'i pyesësh ata të komisionit zgjedhor", ka thënë imami

Mexhiti. Në Bashkësinë Islame të Kosovës thanë se tashmë dihen dy kandidatë për myfti të Kosovës, mirëpo nuk i përmendën emrat, duke thënë se do të dëmtohej procesi zgjedhor.

Për të dy këta kandidatë do të votojë trupi zgjedhor, i cili përbëhet nga 28 delegatë të Kuvendit, 28 kryetarët e

Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës në 28 komuna, si dhe një përfaqësues nga Medreseja dhe një nga Fakulteti i Shkencave Islame.

Naim Tërnavë është myftiu i Kosovës që 13 vjet dhe ka përfunduar mandatin e tretë në krye të institucionit më të lartë të besimit islam në Kosovë.

Rikandidimi për herë të katërt për



këtë pozitë ka ngritur edhe disa dilema dhe njohës të islamit në Kosovë kanë thënë se Tërnavë po e shkel Kushtetutën e BIK-ut.

Njazi Thaçi zgjedhet drejtor i KEK-ut

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Ka përfunduar procesi i përzgjedhjes së drejtorit menaxhues të KEK-ut. Duke respektuar në përpikëri Ligjin e Ndërmarrjeve Publike, sipas kriterëve të konkursit, në një proces krejtësisht transparent dhe objektiv, në bashkëpunim të plotë me ekspertët e partnerit

zbatues nga Ambasada Britanike, pasi kanë kaluar disa faza të intervistimit, Njazi Thaçi ka dalë kandidat më i suksesshëm në garë për pozitën e drejtorit menaxhues të KEK-ut, duke marrë pikët maksimale në dy fazat e intervistimit.

Komisionit i rekrutimit, i përbërë

nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut dhe ekspertët e partnerit zbatues nga Ambasada Britanike, ka bërë vlerësimet e ndara për secilin kandidat, duke i vlerësuar me pikët e arritura gjatë dy fazave të intervistimit. I gjithë procesi ka qenë i monitoruar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, BIRNI.



Aliu: Çmimin e lartë të energjisë elektrike po e paguajmë me pyjet e Kosovës

PRISHTINË, 26 TETOR - Deputeti dhe anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka mbajtur një konferencë për medie në lidhje me gjendjen e pyjeve në Kosovë. Ai ka thënë se sistemi i menaxhimit të pyjeve është i mbushur me burokraci. Aliu ka theksuar se për prerjen e pyjeve ka lëndë në gjykatë, por ato janë për prerës të vegjël.

"Sistemi i menaxhimit të pyjeve është i mingarkuar me burokraci të padobishme. Mungesa e mekanizmave kontrollues dhe llogaridhënës ka krijuar një parajsë për prerësit e organizuar dhe ferr për rojtarët dhe prerësit e vegjël ilegalë. Shteti tregohet i fortë me disa prerës të vegjël, të cilët detyrohen të prenë dru në kushtet kur u rritet çmimi i

energjisë dhe u blloket qymyri. Megjithatë, konfiskimet e shumta të drurëve dhe lëndët e shumta në gjykatë për prerësit e vegjël nuk po sjellin efekte pozitive për shkak se dëmtuesit kryesorë të lidhur në zinxhirë me sharra dhe gatere nuk janë të prekshëm nga shteti", ka thënë Aliu.

Ai ka thënë se kishte shpresuar se gjendja e pyjeve do të përmirëso-

hej me ardhjen e Ramush Haradinajt në krye të Qeverisë së Kosovës. "Ai (Haradinaj) është bjeshkatar i rregullt dhe nuk mungon asnjëherë në bjeshkë, madje edhe kur të gjithë mendojmë se ai do të duhej të ishte i zënë. Së paku, këtu pritim rezultat, por ja që kjo dashuria e tij për malet nuk po na jep rezultate. Po i bie që zinxhiri i organizuar i pre-

rësve të jetë më i fortë se shteti dhe kryeministri, ose i lidhur me ta, pasi unë nuk mund ta besoj se degraduesit e organizuar të pyjeve dhe parqeve tona nuk mund të ndalen. Sot, në vend të pastrimit, ripyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zhvillohet veprimtari degraduese me ndërtime vilash e restaurantesh pa plan dhe pa leje", është shprehur Aliu.



KEDS-i përfundon dy projekte të mëdha në Komunën e Rahovecit

RAHOVEC, 26 TETOR (ER) - Një rrjet krejtësisht të ri energjetik ka instaluar KEDS-i në Komunën e Rahovecit, duke krijuar kështu stabilitet energjetik për banorët e kësaj pjese. Me përfundimin e këtyre dy projekteve, të quajtura TS Komuna dhe Rahoveci V, qyteti i Rahovecit ka hequr rrjetin e vjetër elektrik dhe me vendosjen e rrjetit të ri ka zgjidhur problemin energjetik për 50 vjetët e ardhshëm.

Në pjesën më të madhe të qytetit është instaluar rrjet i ri nëntokësor, sikurse ormanët janë vendosur gjithandej nëpër lagje. Por në

disa zona është vendosur edhe rrjet i ri ajror, përshtatur sipas kushteve të terrenit. Kështu, është larguar rreziku dhe është rritur siguria për banorët e Rahovecit.

Për projektin 'Rahoveci 5 KEDS' ka vendosur një transformator me fuqi prej 1000 kVA dhe kryesisht kablllo nëntokësore si për tensionin e ulët, po ashtu edhe për tensionin e mesëm dhe disa shtylla betoni. Numri i konsumatorëve përfutues janë 209.

Kurse për projektin 'TS Komuna, KEDS' ka vendosur dy transformatorë, njëri me fuqi 1000 kVA,

tjetri me fuqi 400 kVA. Edhe në këto anë të qytetit është instaluar rrjeti nëntokësor, por në disa vende edhe ai ajror, duke iu përshtatur kështu terrenit.

Gjithsej kanë përfituar 360 konsumatorë. Të kënaqur me këto ndryshime energjetike shprehen edhe banorët e kësaj pjese të qytetit. KEDS-i vazhdon të investojë nëpër gjithë territorin e Kosovës. Investimet bëhen kryesisht në vendet ku kompania ka trashëguar rrjet të vjetër. Ky proces do të vazhdojë derisa rrjeti të ketë parametra standardë dhe pajisje moderne.



Qeveria miraton projektbuxhetin për vitin 2019

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019. Të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin e ardhshëm pritet të jenë në shumën prej 2.3 miliardë eurosh. Gjatë prezantimit të Projektligjit, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se përgatitjet e këtij propozimi të buxhetit për vitin 2019 janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin dhe janë në përputhje me të gjithë parametrat financiarë dhe ekonomikë të Kosovës



Gjatë prezantimit të projektligjit, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se përgatitjet e këtij propozimi të buxhetit për vitin 2019 janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin dhe janë në përputhje me të gjithë parametrat finan-

ciarë dhe ekonomikë të vendit tonë.

Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 do të procedohet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Në Projektligj

parashihet rritje e pensioneve bazë prej 20 përqindësh si dhe atyre të kontributdhënësve prej 15 përqindësh, kurse do të rritet buxheti për prioritetet e Qeverisë për vitin 2019, siç janë mbrojtja, rendi, shëndetësia, arsimit dhe mjedisi.

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 TETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar mbledhjen e së premtes së Qeverisë së Kosovës si një mbledhje e veçantë, për faktin se, sipas tij, po miratohet dokumenti me të cilin do të hyjmë në një vit të ri financiar, për ta vazhduar mbështetjen e zbatimit të prioritetëve programore qeveritare.

Qëllimi i projektligjit të miratuar nga kabineti qeveritar është përcaktimi i ndarjeve të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019. Projektligji parashih një rritje të konsiderueshme të të hyrave buxhetore që reflekton qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomik të vendit. Të hyrat e përgjithshme buxhetore në vitin 2019 pritet të jenë në shumën 2,370 milionë euro (dy miliardë e treqind e shtatëdhjetë milionë euro), ndërsa shpenzimet në vlerë 2,365 milionë euro (dy miliardë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë euro).

Shoqata e Bankave të Kosovës shënon Ditën Botërore të Kursimeve



Prishtinë, 26 tetor (ER) - Duke u bashkëngjitur në aktivitetin mbarëbotëror, Shoqata e Bankave të Kosovës nëpërmjet aktiviteve të veta edukativo-arsimore me fëmijë të premtën ka shënuar Ditën Botërore të Kursimeve. Me moton "vepro

mençur, kurse sot", Shoqata e Bankave të Kosovës bëri hapjen e Ditës Botërore të Kursimeve në Shkollën Filllore "Qamil Batalli" në Prishtinë.

Në fjalimin e tij hyrës drejtori i shkollës Liridon Maliqi iu drejtua nxënësve duke i inkurajuar ata që

të kursejnë. Ndërsa në fjalimin e tij drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs, ka theksuar rëndësinë që edukimi financiar ka për krijimin e mirëqenies për të gjithë shoqërinë. Balijs i ka inkurajuar fëmijët që të fillojnë të kursejnë dhe jo vetëm paratë, por

edhe mjedisin, pajisjet e shkollës etj.

Dita e Kursimeve ka filluar të shënohet shumë vjet më parë në Milano dhe kishte për qëllim ta rrisë vetëdijen e popullatës rreth rëndësisë së kursimit dhe menaxhimit të parasë. Ky aktivitet është

organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës me përkrahjen e bankave anëtare: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB Bank dhe Ziraat Bank.

Përkujtohet dëshmori Avni Shehu

Kaçanik, 26 TETOR (ER) - Miq, familjarë, përfaqësues të institucioneve lokale, përfaqësues të OVL-së - Dega në Kaçanik, veteranë dhe invalidë të UÇK-së si dhe qytetarë të tjerë kanë përkujtuar dëshmorin Avni Shehu. Kryetari i kësaj komune, Besim Ilazi, i shoqëruar

edhe nga bashkëpunëtorët, kanë vendosur kurora me lule në kompleksin memorial të varrezave të dëshmorëve dhe kanë bërë homazhe nderimi pranë dëshmorit Shehu. Me këtë rast, Ilazi ka thënë se dëshmorët janë krenaria dhe madhështia e atdheut tonë.



Punohet për jetësimin e Parkut të Biznesit në Prizren

PRIZREN, 26 TETOR (ER) - Nga 40 hektarë sa janë paraparë për Parkun e Biznesit në Lubizhdë të Prizrenit, fillimisht po funksionalizohet hapësira prej 16 hektarësh. Këto ditë është duke u bërë asfaltimi i kësaj hapësire, që do të pasojë me vendosjen e ndriçimit, ndërsa

nevojat e ujit dhe kanalizimit kanë përfunduar. Punishten e kanë vizituar nënkryetari i komunës, Eshref Memaj, dhe drejtoresha e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz. Shumica e lejeve për hapjen e këtij parku janë sigu-

ruar, ndërsa komuna është duke u angazhuar që ky proces të përfundojë sa më shpejt në mënyrë që t'i hapen dyert për mundësinë e investimeve të reja nga bizneset, në të njëjtën kohë edhe të gjenërohen sa më shumë vende të reja të punës.

Në 20-vjetorin e rënies përkujtohet dëshmori Xajë Jashari

Vushtrri, 26 tetor - Sot (e shtunë) në orën 11:00 në fshatin e lindjes Stroc të Vushtrrisë, në 20-vjetorin e rënies, do të përkujtohet dëshmori Xajë Jashari.

"Luftëtari i lirisë veç i falet atdheut - Xajë Jashari, dëshmor i kombit, 19. 06. 1955 - 27. 10. 1998", shkruan në lapidar aty ku prehet në amshim e ku do të bëhen homazhe. Xajë

Jashari shumë vite punoi në Radio Televizionin e Prishtinës. Akademia përkujtimore mbahet në Shkollën Filllore "Liria" në Stroc, nën përkujdesjen e

kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Shoqatat e dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Asfaltohen edhe dy rrugë në Pagarushë

MALISHEVË, 26 TETOR (ER) - Në fshatin Pagarushë të Komunës së Malishevës janë asfaltuar dy rrugë në dy lagje të ndryshme, të cilat lidhin lagjet me rrugën kryesore dhe me pjesën tjetër të fshatit. Asfaltimin e këtyre rrugëve nga afër e ka përcjellë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe

nënkryetari Hajdin Berisha. Begaj ka thënë se rregullimi i infrastrukturës rrugore siguron lëvizjen e lirë të qytetarëve. "Ne jemi duke investuar në infrastrukturën e Komunës së Malishevës me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për të gjithë, përfshirë edhe sigurimin e lëvizjes së lehtë të qytetarëve

në të gjitha vendbanimet", ka thënë Begaj. Ndonëse Pagarusha është një vendbanim shumë i shpërndarë, me lagësi të mëdha ndërmjet lagjeve, infrastruktura rrugore pothuajse është kompletuar, sidomos në rrugët kryesore që lidhin lagjet me rrugën kryesore dhe lëvizja e banorëve është lehtësuar.

Biblioteka e qytetit të Rahovecit 'Sulejman Krasniqi' është pasuruar me 384 tituj librash

RAHOVEC, 26 TETOR (ER) - Biblioteka e qytetit të Rahovecit "Sulejman Krasniqi" është pasuruar me 384 tituj librash të ndryshëm, duke pasuruar kështu fondin librar të kësaj biblioteke, njëkohësisht duke u shërbyer edhe lexuesve për pasurimin dhe zgjerimin e dijeve të tyre. Aktualisht biblioteka e qytetit ka 1 152

ekzemplarë të rinj. Një ndër punët më kryesore të bibliotekës është pasurimi. Duke pasur sa më shumë materiale biblioteka, aq më shumë lexues tërheq. Komuna e Rahovecit, përkatësisht DKRS-së, do ta vazhdojë edhe në të ardhmen furnizimin e bibliotekës me literaturën e nevojshme për të gjithë lexuesit.



Si të mbrohet Kosova nga vetë kosovarët?!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Vërtet jemi në telashe me injorantët dhe arrogantët: Para luftë dhe në fillimin e saj, biri i Dragqit ka qenë sinonim i dhunës dhe të poshtërimin në Llap. I hynte në shtëpi kujt donte dhe rrihte kënd të donte. Kryesisht e përdorte poshtërimin në baza kombëtare duke rrahur në vende publike pleq dhe ata që bartnin plisa në kokë. Mirëpo, ishte i kujdesshëm të mos shkelë në dërrasë të kalbët, aty ku kishte rrezik ta pësonte. Edhe këtij i erdhi fundi, ashtu siç e meritoi. Djemtë e UÇK-së ia hoqën flamën duke e ekzekutuar si një kriminel që edhe ishte i tillë. Po atë ditë, një gazetë tabloid e Beogradit, më duket se ishte, më thirri në telefon celular e që ishte pronë e Kariqëve, por se udhëhiqej nga disa shqiptarë të Pejës që u pasuruan shumë. Pyetja e gazetarit ishte se si e vlerëson z. Shala, si sekretar i KMDLNj-së, vrasjen e një zyrtari të lartë të Serbisë dhe kush mund të jetë prapa këtij ekzekutimi. U përgjigja në pyetjen e dytë duke thënë se vrasjen e tij ka pasur motiv ta bëjë çdo shqiptar e që nuk është bashkëpunëtor i Serbisë duke treguar për dhunën që e ka ushtruar ndaj shqiptarëve. Gjithashtu, thashë se ai ka qenë psikopat i llojit të vet që nuk ka njohur dhe pranuar asnjë vlerë njerëzore dhe morale. Të nesërmen, aty kah ora shtatë (7) e mëngjesit, dola nga banesa ime në Dardani, i bleva gazetën përballë tregut në Ulpianë dhe dikush ma futi dorën në krahë duke më përshëndetur në gjuhën shqipe. U ktheva dhe e pashë Rade Novičevićin, shef i Sigurimit Shtetëror në Llap, i cili m'u drejtua me fjalët: "Ty duhet t'i thyejmë kockat për këtë deklaratë..." duke ma treguar faqen e parë të gazetës së Beogradit ku ishte fotografia ime, me deklaratën që e kisha dhënë, por se isha cituar shumë mirë dhe saktë nga gazetari serb. E pyeta në mos ai donte të m'ihente kockat dhe çka do të bënte pastaj, duke shtuar se edhe vetë shefi i UDB-së është në dijeni se ky farë biri i Dragqit ishte psikopat dhe dhunues. Ai, shefi i UDB-së për Llap, banonte në banesat në Ulpianë, përballë Gjykatës Ekonomike, kishte mbaruar gjeografinë dhe kishte punuar një kohë në ndërmarjen "Ramiz Sadiku", së bashku me patriotin e madh shqiptar

Xheladin Rekalii, të cilin pastaj e kishte rrahur në objektin e policisë në Podujevë, derisa i ishte thyer bishti i fshesës. Novičevići nuk ka qenë udbash tipik apo dhunues i lindur dhe vetë është vlarë në një lokal në Nish nga një paramilitar a ushtar serb, së bashku me disa serbë të tjerë. Xheladin Rekalii ishte patriot i jashtëzakonshëm, modest dhe i hequr keq. Me një fjalë, ishte idealist i papërmirësueshëm. I tillë edhe ka vdekur. Gjatë një ndeje në supermarketin "Vlora" në Podujevë ku punoja thuaja 15 orë dhe të cilin e kisha shndërruar në zyrë të Nënkëshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut për Llap dhe ku mbanim takime me dr. Selmanin, Sylejman (Blakun), Nexhin, Fehmi Blakorin, Afrim Fushën, Bajrush Behramin, Ahmet Hasanin, Arif Ejupi derisa e rrahu policia serbe duke i shkakuar invaliditet të përjetshëm dhe të tjerë që ishin aktivistë të NKMDLNj-së, sikur që takohe-sha edhe me Ahmet Haxhiun, Hakif Shehollin, Fatmir Toplicën dhe anëtarë të tjerë të LDK-së e që përbënin pjesën kombëtare të LDK-së përkundër të tjerëve që kishin për detyrë të bënin propagandë, odë me odë dhe derë më derë kundër Bacë Adem Demaçit dhe të cilët mbanin mbledhje pas së cilës dilnin me qëndrim se: "Të burgosurit politikë shqiptarë janë më të rrezikshëm për ne se vetë Serbia...! Po në këtë supermarket "Vlora", i shitja 200-300 ekzemplarë të revistës "Dielli", brenda 2-3 orëve.

Aty paraqiteshin rastet e keqtrajtimit, silleshin fotografi nga "Foto Kçiku" që bëheshin pa asnjë fening kompensim, caktoheshin ekipet për terren dhe zhvilloheshin aktivitetet të tjera. Nga ai supermarket jam nisur për Zagreb, me dajën Pajaziti, ku jam takuar me dr. Slobodan Lang dhe rektorin e Universitetit të Zagrebit, Zvonimir Sheparović, për t'ua dorëzuar listat e të helmuarve, listat e ushtarëve shqiptarë të vlarë në ish-Armatën jugosllave dhe disa mostra me të cilat më pati pajisur Baca Adem Demaçi. Edhe disa të LDK-së që bëheshin gati për luftë m'u lutën të shoh nëse është e mundur që të sigurohen armë. Në Zagreb pata takuar heronjtë e kombit dhe të shqiptarisë, Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci, banesa e të cilëve, në qendër të Zagrebit, por që ishte shumë modeste, ishte bërë ambasadë dhe qendër logjistike për mobilizim të shqiptarëve. Feha dhe Xheva kishin ndarë mendjen se vetëm me luftë çlirohet Kosova dhe nuk kishin asnjë rrugë tjetër. Jam takuar edhe me Xhafer Jasharin, ish-oficer i Armatës Jugosllave, i cili thoshte se ka

kapacitet dhe mundësi të stërviteshin deri 10 000 shqiptarë në brigjet e Dalmacisë. Kroacia në atë kohë ishte para shpërthimit të luftës dhe armë kishte me bollëk. Nga Burgu i Lepoglavës kisha ruajtur një miqësi me një kroat me nofkën Lima (nuk po ia përmend emrin dhe mbiemrin) i cili më dërgoi në një vend ku kishte arsenal të shumëllojshëm të armëve. Po në atë kohë lulëzonte kontrabanda me duhan (cigare Opatija), detergjent dhe gjësende të tjera sepse nuk kishte kontroll të rreptë në kufi dhe për shkak të situatës politike, policia kufitare e Serbisë korruptohej shumë lehtë. Ata që e mbajnë mend atë kohë mund ta vërtetojnë se një apo dy maune me cigare Opatija u shitej stërshitësve në dalje të Vranjovcit, te tregu i kafshëve, për 30 minuta, pa pasur nevojë të dërgohen fare në depo. Pasi u ktheva nga Zagreb dhe ua tregova çmimin e armëve dhe mundësitë e transferimit në Kosovë, edhe krahu radikal i LDK-së u bë më paqësorë se vet Rugova dhe u mbyllë ky kapitull. Porositësit e armëve edhe sot janë gjallë, kanë poste dhe, fatmirësisht kanë shpëtuar. Takohem me ta për kafe, pa asnjë të keqe. E kishin një kohë të njëjtin qëllim por nuk pajtoheshim për mënyrën e realizimit të këtij qëllimi.

Dy bosanacat, i Vogli dhe i Madhi: Edhe këta ishin shumë të dhunshëm, i Vogli me trup të shkurtër ishte shumë më i dhunshëm se bosanaci i Madh. Që të dy ishin nga Bosnja ku e kishin përsosur luftën dhe krimin ndaj Myslimanëve dhe kroatëve. Në Podujevë dhe Llap ushtronin dhunë të madhe prandaj përfunduan ashtu siç edhe jetuan, në mënyrë të dhunshme. Bosanaci i Vogël duket se e qëroi Zahiri i cili, te Shtëpia e Shëndetit në Podujevë hyri nën një shaht mbi të cilin e kishte parkuar veturën Bosanaci i Vogël ku priti disa orë dhe, me të hyrë në veturë polici serb, Zahiri apo dikush tjetër i gueriles së UÇK-së zbrazti armën duke e lënë për vite të tëra në karrocën e invalidit.

Bosanaci i Madh kishte shumë dëshirë të luajë lojëra të fatit apo tombolën. Kishte hyrë në kafën e Selit, i kthyer nga xhami kah rruga në udhëkryqin për fshatin Peran, Bajčinë dhe Kërpimëh dhe mbante tiketën në dorë kur dikush nga guerilja e UÇK-së e goditi me armë zjarri.

Ishte edhe një tjetër inspektor serb i UDB-së që ishte vlarë në rrugën Podujevë - Prishtinë, me të kaluar fshatin Lluzhan.

Kolaboracionistët shqiptarë: Zahir Pajaziti ishte guerilas dhe atentator i lindur, së bashku me një grup shokësh. Përveç udbashëve serbë ata qëruan edhe udbashët shqiptarë sikur

që ishte Bejtushi, Maliqi dhe Rama. Me një fjalë, Zahir Pajaziti, me shokë, për një kohë e kishte lënë Podujevën fare pa udbashë, apo, së paku nga ata që njiheshin në publik si të udbash dhe që ushtronin dhunë ndaj civilëve shqiptarë apo që mbysnin nën dhunë aktivistë politikë dhe patriotë. Në një rast tjetër sigurisht se do të zgjerohem edhe më shumë.

Pse e bëra këtë hyrje dhe pikërisht në këtë kohë: Nuk ka asgjë më e keqe se të bëheni të dhunshëm dhe të dhunoni të tjerët vetëm nëse keni fuqi politike, materiale apo status shoqërorë që ua mundëson këtë. Nuk ka rast që dikush ka qenë i dhunshëm e që e ka përfunduar jetën duke kultivuar lule përveç Don Vito Korleones pas plagosjes së rëndë që iu bë apo duke ligjruar për mjete paqësore të zgjidhjeve të problemeve. Nga historia kemi mësuar se dhuna e lindë dhunën dhe se, siç thoshin latinët e moçëm: "Kush me shpatë jeton, nga shpata edhe do të vdesë". Kohëve të fundit, arrogantë të veshur me fuqi politike apo, kryesisht familjarë të tereqëve politikë, ushtrorë dhunë ndaj qytetarëve pa iu nënshtruar asnjë procedurë ligjore. Arroganca e tyre është e neveritshme, intelektualizmi i tyre është në nivelin e një idioti. Në jetën e vet nuk e kanë lexuar një libër të vetme ndërsa janë bartës të titujve shkencorë dhe akademikë. Këta i kanë zënë vendet kompetente, të armatosur me tituj dhe grada shken-core, të imunizuar nga çdo lloj përgjegjësie dhe të herkularizuar nga çdo lloje ndjekjeje ligjore. Për mendimet tim këta janë më të këqij dhe më të dëmshëm se biri i Dragqit, të dy bosanacat dhe kolaboracionistët tjerë. Këta janë më të rrezikshëm dhe më të dëmshëm se të gjithë bashkë, që janë qëruar me plotë të drejtë nga Zahiri me shokë. Nuk janë sakrifikuar mijëra dhe dhjetëra mijëra shqiptarë, që nga Tif Fusha të cilit nuk i dihet as varri, nga Shaban Shala që është mbytur nën dhunë në burg duke kënduar se: "këtu more nuk është Serbi por është Shqipëri...", nga Xheladin Rekalii, Zahir Pajaziti dhe Ali Ajeti, Bajrush Behrami dhe qindra e mijëra ish të burgosur politikë, luftëtarë të së lavdishmes UÇK-së, invalidë të luftës, martirë dhe heronj të Kosovës, që një grup banditësh të luaj me jetët tona, me jetën e fëmijëve tanë, me të kaluarën e lavdishme plotë sakrificë dhe me ardhmërinë tonë. Nëse në kohët më të vështira nuk e kemi duruar dhunën, pse duhet ta durojmë sot?!

Si të mbrohet Kosova: Kurrë nuk ka qenë më lehtë të mbrohet Kosova se sot. Formula është shumë e thjeshtë; të mbrohet Kosova në kufijtë që është pran-

uar nga 115 shtete ose, nëse dikujt i kruhet prapanica me luajt me kufij, po i shtrojmë edhe kufijtë e Serbisë, Malit të Zi dhe të Maqedonisë, që nga themelimi i këtyre shteteve e deri më sot për faktin se këto shtete kanë hyrë shumë borxh te shqiptarët duke i marrë shumë toka. Përralla janë se mund ta marrim Luginën e Preshevës dhe mos të japim asgjë. Po e jap një zotim publik; nëse Hashim Thaçi është i zoti ta bashkojë Luginën e Preshevës pa i dhënë asgjë Serbisë, do të nisem nga pragu i shtëpisë në Prishtinë zhargas duke shkuar dhe puthur çdo milimetër, deri në Burojë, dhe atje do ta puthë edhe qenefin e Hashimit sikur që do t'ua puthë këmbët krejt thaçëve të Burojës dhe atyre që nuk e kanë mbiemrin Thaçi. Ky është zotim publik dhe unë e mbajë fjalën!

Këta të Luginës së Preshevës që po e përkrahin Hashim Thaçin në këtë projekt të çmendur të lojës me kufij e që pashmangshëm do të përfundojë me luftë, moti janë bashkuar me Kosovën, qysh para 30-50 vjetëve, kanë krijuar familje, punojnë këtu dhe bëjnë biznese kurse, Luginën e Preshevës e vizitojnë aq sa edhe unë e vizitoj Afganistanin, Pakistanin dhe Izraelin ku nuk kam qenë asnjëherë!

Nuk ka ndryshim të kufijve, ka Asociacion me kompetenca ekzekutive nëse Agim Bahtiri deri atëherë nuk do të jetë gjallë dhe vetëm pas 20-25 vjetësh do të ketë korigjim të kufijve. Nuk do të ekzistojë Kosova si shtet dhe as Bosnja si shtet. Duket se edhe Maqedonia do të çkatramohet. Besoj se në atë kohë në një botë tjetër, bashkë me Bacën Adem do të bisedojmë për çështjet nëntokësore që me aq shkathtësi po i drejtojnë do dhunues sot në Kosovë. Baca Adem ka përparësi sepse beson në rikthim në një formë tjetër dhe në një trup tjetër kurse unë nuk besoj. Besoj se jeta jonë përfundon në këtë botë dhe në këtë pikë nuk pajtohemi me Shefqën dhe Papë Françeskun.

Krejt për fund: me Serbinë mund dhe duhet të bisedojmë për çështje që bisedojnë dy shtete nga pozita e barabartë e kurrsesi ta marrim rolin e gjeodetit apo kadastrës. Duhet ta kuptojmë se Kosova ka territor më shumë se çdo prapanicë e politikanit, e çfarëdo madhësie qoftë ajo. Kush e identifikon Kosovën me madhësinë e karriges ku e vendos prapanicën dhe në përputhje me këtë i bënë llogaritë, nuk e ka fundin e mirë sepse, përveçse nuk e duron rob, nuk e duron as toka. Duhet shekuj e shekuj që kjo tokë të kullohet nga gjaku i derdhur prandaj, respektojeni më shumë. Respektojeni deri në fund sikur që çdo shtet e respekton tokën e vet, me histori apo pa histori qoftë!

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /6/

Ja për çfarë akuzoheshin Qamil Jemini e Sadik Mehmet Peçani



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Qamil Jemini e Sadik Mehmet Peçani akuzoheshin edhe për fajin e treguam në nr. 1 edhe për këto: Përse në vjetin 1943 e 1944 kanë qenë funksjoneer aktivë të Komitetit Rrethit në Suharek, t'organizueme prej organizatë tradhtare Lidhja e II e Prizrenit nën kryesin e Xhafer Devës, me qëllim e për llogari dhe nën udhëzimet e okupatorit Fashist-Gjerman kanë krye mobilizimin e popullit Shqiptar që t'a dërgonin në luftë kundra lëvizjes N.Ç. kanë mobilizue djelmosha në Divizionin SS. Skënderbeg dhe i kanë dergue kundra Shqipnis së re dhe Armatës Jugosllave, për këtë qëllim kanë shërbye dhe janë qenë si anëtar të Komitetit Rrethit të Lidhjes II Prizrenit, kanë punua aktivisht në shërbimin t'onë; këtë gjë kanë formua fajin e parapanë artikullin 3 pika 4 në lidhje me artikullin 2. Iaza e 1. 1 mbi krimet e bamun kundra popullit e shtetit, e ndëshkueshme si mbas artikullit 4 fraza e 1 të njëjtë Ligjës.

Xhemil Fluku i quajturin "Kumona", Sefedin Ahmeti i quajturin "Plumbi", Abdyl Hajrullahu, Abdyl Hamza i quajturin "Paljaço" dhe Sinan Hëzëri për këto veprime:

Përse në muajin maj 1945 tue veprua si mbas direktivave të maruna prej Kryetarit të Bandës Balliste Riza Aliut ka fonme Komitetin e Rrethit në Prizren me qëllim që të përhapin një propagandë dhe të fusin një dizarmoni në pushtetin populluer, dhe kundra Regjimit të sotshëm, të bajnë spiunazh në dam t'Armatës Jugosllave për llogari të këtyre bandave, të furnizojnë bandat e aratisuna me ushqim, me veshmbathje, me armatim, e për ët gjë kanë mbajtur konferenca në Prizren dhe n'afërsit jashtë Prizrenit, nëpër këto konferenca kanë asistua dhe kryetarët e Ballistëve Riza Aliu e Sali Zhuri, ku janë përforcua organizatat dhe janë transmetua informatat dhe propaganda, janë caktua detyrat e funksioneve në Komitet, në këtë mënyrë ose rast asht zgjedhur si kryetar i pandehuni Xhemil Fluku dhe i pandehuni Sefedin Ajhmeti si sekretar, e i pandehuni Sinan Hëzëri si propagandist dhe përgjegjës politik, të pandehurit Abdyl Hajrullahu u asht caktua përgjegjësia për mbledhjen e gjanave të nevojshme për t'ju der-

gue bandave, pse gjatë muajit maj 1945 dhe Qershuer të K.v. kanë mbledhur e dergue Bandave t'armatosuna 2000 kg. drithë afër 50 kg. Kripë, 30 palë opinga, 12 kg. duhan, një shumë të madhe të hollash, armë dhe disa bomba; pra tue dijtun se bandat Balliste janë në luftë tarmatosun kundra Regjimit të sotshëm dhe armatës Jugosllave pa marrë parasysh asnjë gjë kanë ramun d'akordë me këta dhe i kanë ndihmuar në veprimet e tyre tradhtare, kanë punua aktivisht me përhapun propagandën, me mbledhin informata me anë të spiunazhit, me grumullu ushqim, veshmbathje, dhe me armatim tue formua për këto arrsyena fajin e parapamë n'artikullin 3 pika 1 në lidhje me artikullin 2 e artikullin 11 të Ligjit mbi krimet kundra popullit e Shtetit, e ndëshkueshme si mbas arti-kullit 4 fraza e 1 të njëjtë Ligj. Sefedin Ahmeti akuzohet, përveç fajit të sipër treguam në nr. 1 dhe për këto:

Pse në muajin Qershuer 1945 si sekretar i Komitetit Ballist në Prizren ka ra në kontakt me t'aratisunit tue shkue personalisht në mal, dhe tu çua lajme e informata, dhe tue marrun prej këtyre instruksione se si me veprua për këtë arrsyë ka ngelun disa ditë atje me ta, dhe në këtë rast ai bashkë me kryetarët e Ballistëve kanë përgatitun projektin dhe dhanë vendimin për me zhdukun shokun Xhavit Nimanin Kryeshef i Punëve të Mbrendëshme të Kosmetit, dhe bashkë me te dhe disa përgjegjës të tjerë në Prizren, tue hartua se do të dërgonin në qytet një Grup Ballistësh për të tentua vrasjen e Xhavit Nimanit me shokët e tjerë, dhe njëkohësisht me bamun një alarm në qytet, e pas kësaj të tërhiqeshin. Pra, i pandehuni Sefedin ka marrë pjesë aktive me bandat e aratisuna, gjithashtu në dhanjen e vendimit dhe në projektimin e planit për atentate kundra personave të pushtetit tonë populluer. Pra ka formua fajin e parapamë n'artikullin 3 pika 7 në lidhje me artikullin 2 fraza e 1 të Ligjit mbi krimet kundra popullit e Shtetit, e ndëshkueme në mbështetje t'artikullit 4 fraza e 1 të njëjtë Ligj.

Rifat Krasniqi i quajturin "Sokrat - Skënderbeg", Kajtaz Ramadan, i quajturin "Leka", Ahmet Derguti i quajturin "Haj" Kadri Minushi, i quajturin "Vrugë", Sheh Muhedini i quajturin "Jemen" dhe Vahit Mustafa akuzoheshin për këto vepra: Në muajin mars të 1945 në Rahovec kanë krijuar tashtuqaj-tunin "Komiteti Nacional Demokratik" për Rrethin e Rahovecit me qëllime politike e lufte t'armatosun e kundra rregullimit të Jugosllavisë Demokratike Federative, dhe pse i pandehuni Rifat Krasniqi ka qenë si inisjator dhe organizator kryesuer i Komitetit në fjalë, e së bashku me te edhe të gjithë anëtarët e

Komitetit.

a). Ka zhvillua e zgjanue organizatën e Komitetit nëpër Komunat e Rrethet e Rahovecit, tue shtimun të marrin pjesë shumicën e njerëzve të cilët si këta kanë pasun qëllime anmiqësuer kundra themelimit të Jugosllavisë re, ky Komitet ka pasun ndër mendë që në çastin e duhur kur të vinte koha, si ata kanë mendua ta përmbysonin pushtetin dhe t'a zëvendësonin vet ata në këtë mënyrë do të bëheshin organe të lëvizjes profashiste në Kosovë e Metohi.

b). Kanë përhapen një propagandë provokuese e gënjeshtare në masat Shqiptare, tue ju thanun këtyre të funit që nuk kemi as ma të voglën të drejtë në Jugosllavin e re, që jeni të robnuem dhe duhet të luftojmë që sjellim lirin eplot t'onën, në këtë mënyrë kanë futun një anmiqësi në mes tëpopujve Shqiptar dhe të Popujve Jugosllavisë, tue vazhdue me propagandën e tyre kanë theksue vuajtjet ni janë detyrue me bamun për shkak të luftës N.Ç., dhe ato vuajtje e mundime i janë ngarkua në kurriz vetëm popullit Shqiptar dhe jo popujve të tjerë të Jugosllavi, të gjitha këto veprime e gënjeshtre i kanë bamun për të vetmin qëllim që të krijojnë një atmosferë të frymzueme për një kryengritje kundra Regjimit të sotshëm.

c). Kanë përhapun propagandën gënjeshtare gjoja se në mes t'Aleatve ekziston një dizarmoni dhe se Jugosllavija e Titos nuk njëjet prej Aleatve.

ç) Janë përgatitun dhe kanë ftue popullin Shqiptar që t'armatoset sa ma shpejt tue blemun armë dhe tue i ruejtun këto që mos t'ja dorzojnë anmikut, këtu d.m.th. pushtetit populluer, pa dorzue ma para kryet e vet, kështu të jet gati e përgatitun në kohën e duhur kur do të vije dita që të gjitha këto forca së bashku do të sulmojnë pushtetin populluer e do t'a përmbysin siç shifet prej letrave që personalisht ka shkruet dhe i ka përhapun në masën e popullit Shqiptar i pandehuni Rifat Krasniqi.

d) Kanë mbledhun material si ndihmë për bandat e armatosuna Balliste tue i konsiderua këta të fundit si ushtri të veten.

dh) Janë lidhun me Komitetin Ballist në Prizren me kondit të ndihmonin njani tjetrin, dhe kanë bamun për qëllim të lidheshin me Komitetet në Drenicë, Suharekë, dhe Gjakovë.

e) Për me forcua organizatën e tyre tradhtare kanë bamun betimin që do të luftojmë kundra Regjimit të sotshëm deri në pikën e fundit të gjakut, dhe që nuk kemi me tradhtua Komitetin që vet e kemi krijuar; në rast se ndokush prej nesh e tradhton Komitetin nuk e pret tjetër gjë vetëmse vdekja e sigurt. Këtë betim kanë bamun të gjithë të pandehurit.

Pra, kanë krijuet një organizatë e cila ka bamun një propagandë gënjeshtare, kanë punua në

furnizim të organizatave të reja baliste dhe në tërheqjen me lëvizjen (...), të gjitha këto me qëllim që me anë të forcës të shkatërrojnë themelet fillestare të Jugosllavisë Demokratike Federative. Në këtë mënyrë tue qenë koshjent e ma paramejtim kanë formua fajin e parapamë n'atikullin 3 pika 1 në lidhje me artikullin 2 fraza e 1 të mbi krimet e fajet kundra popullit dhe Shtetit, e ndëshkueme në bazë t'artikullit 4 fraza e 1 dhe të artikullit 11 të njëjtë Ligj.

Kadri Minushi përveç fajit të sipër treguam nën nr. 1 akuzohet edhe për këto:

Pse në vjetin 1941 në malin e katundit Svërka në Rrethin e Rahovecit ka pritur në pusi me gjithë do shok tjerë katundarin Pante Senic e Llazar Senic, të cilët athere kishin ikun prej tokës së tyre që të largoheshin prej terrorit fashist, dhe të dy i ka vramun. Për këtëarsye ka bamun fajin e parapamë simbas paragrafit 167 fraza e 2 pika e 1 të Ligjit penal, dhe e ndëshkueshme me të njëjtin paragraf.

Ahmet Dërguti për veç fajit të sipërtreguem nën nr. 1, akuzohet edhe për këto:

Pse në pranverën e vjetit 1945 si Intendent i Komandës së Vendit në Rahovec tue punu aktivisht për Komitetin në të cilin bante pjesë ka grumbullue ndihma për bandat Balliste n'aratisuna, tue tërhhjekun prej magazinës ushtarake 2000 kgr. Drithë dhe 200 kgr. Lesh, për këtë gjë ka formua fajin abuzim në detyrën e tij, i parapamë n'artikullin 15 të rregulloreve të Gjyqit Ushtarak, e ndëshkueshme në mbështetje t'artikullit 16 e 17 të njëjtës rregullore, dhe në lidhje me artikullin 1 të Ligjit mbi dënimet e ndryshme, - dhe me bazë të artikullit 11 të njëjtë ligj.

VII.

Rexhep Abdulla Kabashi, të qujtun "Tomorri", akuzohet për këto:

1. Përse në fillim e në gjysmë të vjetiti 1945 ka marrun lidhje e asht ramun në kontakt me të pandehurin Tahir Dedën, mbasi kanë ramun d'akordë, asht bamun vegël dhe ndërlihdja kryesore të Tahirit dhe kryetarëve të bandave t' aratisuna, të cillat n'at kohë luftonin në Drenicë kundra ushtrisë N.Ç. Jugosllave, ka dergue postën q'i pandehuni Tahir Deda e drejtonte banda e armatosura n'adresë të Profesor Ymer Berishës, i cili. Ju përgjigjtë të pandehurit Tahir, dhe kur Posta ose letra nuk kishin mundësi me depërtua për shkak të luftës atëherë i pandehuni Rexhep i çilte dhe i këndonte e pastaj për përmbajtjen e tyre ja referonte të pandehurit Tahir, nga tjetra anë si mbas udhëzimeve të dhanuna gojarisht prej Tahirrit, ai d.m.th. Rexhepi i shkruante personalisht letrat dhe ja dërgonte Ymer Berishës, për këtë gjë ka formua


fajin e parapamë n'artikullin 11 të Ligjit mbi krimet dhe fajet kundra popullit dhe Shtetit, të ndëshkueshme si mbas e në mbështetje artikullit 6 dhe 1 të njëjtë Ligj.

2. Pse si sekretari i Këshillit Populluer të Komunës në Lubizhdë, tue përfitua nga pozita, ka keqpërdorë dhe abuzua detyrën e tij tue mbledhur shënime informata mbi Ushtrinë tonë, mbi forcat e saja dhe mbi lëvizjet e saja, tue dorzue këtë të fundit Tahir Dedës, tue qenë i sigurt dhe tue dijtun fort mirë që ai banë pjesë në një organizatë ilegale e si i tillë asht i lidhun me bandat e aratisuna, për mbajtjen e këtyre shënimeve e informative i dërgonte ose i përcillte tek bandat në fjalë. Pra ka bamun spiunazh në dëm të Shtetit dhe në favor të bandave të arratisura kundërshtare të Regjimit sotshëm, për këto arrsyena ka formua fajin e parapamë n'artikullin 3 pika 10 në lidhje me artikullin 2 fraza e 4 e njëjtë Ligj.

VIII

Kadri Ramadan i quajtur "Topall", akuzohet për këto vepra:

1) Përse si pjesëtari organizatës Balliste, e cila ka fasë për qëllim kryesor përmbynsjen e Regjimit të sotëm të Jugosllavisë Demokratike Federative, ka ramun në kontakt e në lidhje me bandat e arratisuna në mal plus dhe me Komitetin Ballist në Prizren, gjithashtu edhe me Komitetin Femnuer Ballist në Prizren, me anën e tij ka marrun ndër lidhje Postat, informatat dhe tue pru prej atyre Postën dhe udhëzimet, tue dergue material të mbledhur në qytet bandave në fjalë si p.sh. bombe dore, municion, pushkë, e të tjera, pse në muajin Majë të këtij viti ka shoqnuet dhe futun në Prizren Kapiten Riza Aliun, një ndër nga kryetarët e Bandave Balliste, i cili ka asistua në konferenca dhe i ka vu në kontakt me Komitetin Ballist të Rrethit Prizrenit, pra për këto ka formua fajin e parapamë n'artikullin 11 të Ligjit mbi krimet e fajet kundra popullit e Shtetit, e ndëshkueshme në mbështetje të njëjtë artikull dhe të njëjtës Ligj. (Vijon)



NJË MONUMENT PËR DERVISH SHAQEN

(Bajram Halil Gashi: Ah... Shqipni... mos thuj mbarova, kushtuar Dervish Shaqës, Demush Nezirit dhe grupit kosovar, Durrës, 2018)

Prof. Ymer GASHI

Libri i Bajram Halil Gashit që po përurojmë sot është një tekst që shtrihet në mes të monografisë dhe kujtimeve, në mes të dëshmisë dhe evokimeve personale, me të dhëna orale dhe arkivore, të ngritura mbi përvojën e jetës e të librave, të historisë e faktografisë, të gojëdhënave e rrëfimeve të besueshme.

U mor vesh, libri në fjalë ka një temë bosht, dy doajenët e folklorit shqiptar, në të dyja anët e kufirit të Shqipërisë shtetërore. Që nga titulli dhe nëntitulli jepen të dhëna se kemi të bëjmë me një libër që do ta trajtojë me ngulm: historinë, jetën e Dervish Shaqës dhe Demush Nezirit dhe jo vetëm të tyre.

Duke qenë se folklori është kultivuar në odë, është edhe një pikëvështrim për traditën popullore, por edhe me një kulturë sjellje e komunikimi, që ngadalë veprën e bën të rrëshqasë në një tekst tipik me elemente etnografike e antropologjike.

Duke qenë se ata ishin, siç thuhej zëri i Kosovës, i trevës së Dukagjinit "Ah Shqipni mos thuej marova" vjen si moto, si simbiozë e bashkimit kombëtar, por edhe si përshkrim i travajëve të kohës, andej e këndej kufiri, ashtu siç thoshte vetë kanga e Dervish Shaqës "Kurt ta ktheva Kosovë shpinën, e lashë borë e gjeta dimen".

Siç dëshmon edhe libri i Bajram Gashit, ishte dimër i vërtetë politik e historik për shqiptarët e Kosovës, të cilët më mirë se ku pasqyrohet në veprimtarinë e këtyre dy zëdhënësve më të mirë të historisë e të kulturës shqiptare.

Pse themi kështu?

Është thënë, Rrafshi i Dukagjinit është një ndër trevat shqiptare që i dha shumë folklorit burimor. Dervish Shaqa e Demush Neziri nga Lluka e Epërme, nga vendi historik i Verrave të Llukës, ku u mbajtën Kuvendet e Besëlidhjes Shqiptare, ashtu siç thuhet në historiografinë shqiptare dhe në dëshmitë e kohës, në natën e 8 marsit 1956, në dasmën e Demë Isufit, Dervish Shaqa la një këngë për gjysmë, për ta vazhduar 'matanë bjeshkës', sepse UDB-a iu kishte vënë pas. Të njëjtën natë, bashkë me Demush Nezirin, Adem Ramën dhe me nipin, Isa Hoxhën, kalojnë

kufirin. Vetëm ata që i kanë kaluar ato bjeshkë, sidomos edhe në luftën e fundit, e dinë mirëfilli çfarë është, siç thotë kënga kreshnike: "Çka asht zori e munimi", pa lënë anësh ndarjen nga familja, rrethi e farefisi, nga bashkëvendësit që nuk bënin dasmë pa zërin e artikuluar në telat e sharkisë.

Trajtimi i zakoneve të odës, sa nga të dhënat historike, kur e kur, nga kallëzimet e personaliteteve historike, po edhe të familjeve të mëdha, prej derës së shtëpive të pleqnarëve, ka dashur mund e durim. Mbi të gjitha, një pasion dhe atdhetarizëm. Bajram Gashi ndjek një model pune, jashtë metodave të thata e skolastike; ofron material burimor, okular, pastaj atyre ua vesh referencat të besueshme e të verifikueshme.

Gjithashtu, motiv shtytës, dihet, del edhe vetë jeta e autorit të këtij libri, duke qenë vetë i përndjekur nga Kosova, ndaj më mirë se kush e kuptoi braktisjen e dhunshme të atdheut, prandaj ilustrimet me rrëfime, herë autobiografike, herë historike, herë popullore, e bëjnë një libër mozaik, një libër monumental e shumëdimensional.

Prandaj, qysh tani pa dilemë themi se çfarëdo që thuhet për këtë libër, që lexuesi e ka shfletuar dhe ai që do ta shfletojë, nga fillimi në fund, nga mesi në fillim, apo nga fundi në fillim, mund të jetë e tepërt: sepse ky libër mund të lexohet në çdo kohë dhe nga cilado faqe e tij, me një frymë, fakt ky që nxjerr në pah argumentin thelbësor: jetën e veprën e Dervish Shaqës e Demush Nezirit me shokë, historinë e traditën, kulturën e subkulturën, vendin e kuvendin, sfidat e mëdha për mbijetesë.

Edhe pse duke qenë herë me nota autobiografike, autori në tërë këtë libër voluminoz përpiket dhe arrin që vë në plan të parë njeriun që ecën vertikalisht.

Kjo shihet në secilin kapitull, si te mevetësia e cinguar e Kosovës, po ashtu edhe te shpërnguljet nga trojet etnike. Nuk janë vetëm ecejaket e gjysmës së dytë të shekullit njëzet por, kur e kur, edhe terratisjet masive që lanë plagë të madhe te njeriu, te familja, te shoqëria, te kombi ynë.

E kush më mirë se Bajram

Gashi, ky kërkues i fisëm, i përkushtuar e i përvuajtur pas historisë, ky admirues i madh i Dervish Shaqës me shokë, ka prekur këtë plagë, duke na afruar të gjallë portretin e tij, jetën e tij, idealin dhe kulturën e lindur dhe të kultivuar në odat ku i ndihej zëri, siç thotë populli, në "t'shtatë copë Llukë".

Ky libër jete, sa është histori krenare, së fundi duhet pranuar edhe anën njerëzore, të prekshme, të ndjeshme, dilemat dhe paradokset e kohës si te kapitulli "Aksioni i armëve 1955-'56" dhe pasojat tragjike për shqiptarët e Kosovës.

Për këtë periudhë është shkruar, është folur, është dëshmuar shumë, por pas leximit të këtyre rrëfimeve historike, ne shohim më mirë më sytë e mendjes e të shpirtit, me sytë e gjallë, si në një kalediskop që rri në vij të kufirit, të njëjtën histori, të thënë më ndryshe, të shkruar më ndryshe dhe, natyrisht, të lexuar më ndryshe.

Këtu e tani kuptojmë më mirë se në dosjet sekrete të Arkivit Shtetëror të Shqipërisë për pasojat e djemve të Kosovës, që atëbotë shkuan në tokën e premtuar, Shqipërinë amë. Bajram Gashi, ky përvuajtës i regjur në jetë dhe në letra, në edukim brezash, na ofron portrete e ngjarje fort interesante, përmes një argumentimi bindës e plot trishtim.

Në këtë mënyrë, Bajram Gashit më mirë se kujt i rri epiteti Mësues i Popullit jo vetëm se ka ushtruar këtë zeje të shenjtë për vite me radhë, atje ku tallazet e detit vinin me këngën dukagjinçe, por për informacionin e gjerë që ka një intelektual si ky. Sërish, shtrojmë pyetjen: Pse themi kështu?

Ai njeh kulturën e subkulturën dukagjinase, familje e burra të urtë e n'zâ, tribunë popullore, dallime e përbashkime në mes tyre, shenjë kjo e njeriut të burëruar nën frymën e truallit të të parëve të tij.

Natyrisht, pjesa më e mirë, që vjen si një tragjedi antike në disa akte, e ku njëri akt është kulmi, janë pjesët ku në detaje shkruan të zezën mbi të bardhën fletë, pikërisht kur flet për Dervish Shaqën dhe Demush Nezirin, se si kthehen ata në kujtesën e bashkëkohësve, se si kujtohen nga familjarët, bijtë e Dervishit, miqtë dhe atdhedashësit e tij.

Gashi, me durim e përpikëri,



madje duke e ruajtur frazën e ligjërimin dukagjinase, na sjellë rrëfimet e tyre të plota, të trishita, të papara dhe të palexuara më parë.

Dhe, pasi i lexojmë vetvetiu themi:

Si nuk u thanë deri më sot të gjitha këto?

Mbi të gjitha, sa shumë kemi menduar se e kemi njohur dhimbjen, mallin fëmijëve pa baba, e gruas së ve me burrë gjallë, e nënës fisnike e besnike, tamam si Penelopa që pret Odiseun e saj.

Dhe jo vetëm kaq, secili rrëfim, dëshmi e tyre, mund të lexohet e të ruhet si një dokument, si një testament se ç'rugë u ndoq, se kush u poq për këtë liri.

Sado që vlerësimet kritike janë gjykim, vlerësim objektiv, është e pamundur të mos thuhet e të

shkruhet edhe mbresat personale për njeriun që u rrit duke kënduar dhe vdiq me këngë në gojë, bashkë me Demush Nezirin, mikun dhe sivëllain e tij të pandarë kudo, në arratisje, në skena festivalesh, në këngët që na frymëzuan, na kalitën për beteja të reja.

Prandaj, libri i Bajram Gashit, në kullën e madhe të historisë, është një frëngji prej nga bëhen bashkë vuajtka dhe liria, kënga dhe pushka, me jehun e përjetshëm atëherë e sot:

Ah shqipni mos thuej marova
Se djemtë e tu hala janë gjallë.

E fryma e gjallë nuk ka se si të mbahet më mirë se kështu, duke kujtuar e dëshmuar në fjalë e vepra, si kjo e Bajram Halil Gashit!

POEZIA MEDITATIVE DHE MILITARE E ARIF MOLLIQIT

Arifi u reagon edhe komandantëve të luftës që i kanë keqpërdoruar në paqe, për interesa personale dhe familjare, institucionet e Republikës së Kosovës, duke u pasuruar shpejt dhe duke e dëmtuar buxhetin e Kosovës shumë. Ata kanë bërë mirë që kanë luftuar dhe e kanë çliruar vendin nga Serbia, po ata s'kanë të drejtë as të veprojnë kundërligjshëm dhe as të na thonë, shkruan Arifi: "Ne ju çliruam, ne kemi të drejtë t'ju pallojmë!" Tekefundit, nëse bëjnë kështu si thonë, morali i tyre bie përtokë, paralelisht me respektin tonë për ta

B. Armagedoni

Është hera e dytë kjo që marr pjesë në promovimin e librit të Arif Molliqit. Është hera e dytë që flas për librat e Arifit në një ambient tjetër për dallim nga hera e parë. Herën e parë kam folur në vendlindjen e tij, në Deçan, veçse për një libër tjetër të tij. Jo për romanin "Kryeqytetin e lakuriqëve", po për monografinë "Lluka e Epërme ndër shekuj", me të cilën, më shumë se vetveten, Arifi ka nderuar pararendësit, historinë e tyre, familjarët e vet dhe tuajt që i keni të një rrënjë, ju të Llukës së Epërme, shpërndarë nëpër Kosovë dhe migruar në vende të ndryshme të botës. Pa dyshim se me këta libra që ka botuar deri më tash, edhe me disa të tjerë botuar para këtyre që i kam botuar unë me shtëpinë botuese "Armagedoni", Arifi dhe veprat e tij kanë zënë vend në letërsinë bashkëkohore shqiptare, në historinë e saj, në raftet e bibliotekave tuaja dhe në kujtesën tuaj. Në katalogët e shtëpisë sonë botuese, patjetër.

Arif Molliqit, në vitin e tretë të bashkëpunimit me të, me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës të Republikës së Kosovës, i kam botuar këtë vepër me poezi, në të cilën ka dashuri, ka simpati, ka përkushtim, ka reagime kundër politikës vendore dhe botërore, për ngjarje të mëdha që shqetësojnë botën, edhe për ngjarje më të vogla, po që përbëjnë lajme; për luftëra të ndryshme dhe të shumta, edhe për vrasjet e fundit në Aleppo, edhe për ngjarjet e parafundit politike në Kosovë, si: për tërheqjen e litarit për prerjen e kufirit me Malin e Zi, për prishjen e shtratit të Lumëbardhit me vendim ministri, për gjenealogjinë dhe traditën shekullore të banorëve të Llukës së Epërme, për punën e përditshme të zyrtarëve të shtetit, të politikanëve të kor-

ruptuar dhe për popullin e tij të nëpërkëmbur, të ndaluar dhe të sunduar edhe në paqe, nga politika vendore dhe e huaj.

Arif Molliqi tashmë ka arritur moshën e pensionimit. Datën e saktë të lindjes së tij nuk e di po, nëse nuk i ka bërë ende, deri më 31 dhjetor, po qe se ka këtë shëndet të mirë si sot, do t'i bëjë 65 vjet. Në këto gjashtë dekada e gjysmë të jetës Arifi ka punuar shumë. S'po i bëjmë dhe as nxjerrim llogaritë e punës fizike dhe administrative që ka bërë një kohë në Kosovë, një kohë tjetër në Gjermani. Po i bëjmë një llogari tjetër, intelektuale, prej kur ka nisur të shkruajë dhe të botojë në gazeta humor të zi dhe satirë me pseudonimin Boksh Baruti, Topuz Bërryli dhe me të tjerë, duke e vazhduar krijimtarinë letrare me botim të librave, fillimisht me poezi, pastaj me ese, skica, mbresa, romane, drama, monografi. Këto zhanre i ka shkruar Arifi. S'i ka shkruar sa për t'i shkruar. I ka shkruar me stil. Me përgjegjësi. Me ndjenjë. Me mendje të kthjelltë.

Nëse këtu është dikush prej jush që nuk keni lexuar asnjë vepër të tij, dëshminë më të mirë për shkrim të qartë, për lloje të figurave, për fjalë me masë dhe për fjalë që vrasin ndërgjegjen e njerëzve të korrumpuar, të brishtë, të pasinqertë, e keni në këtë libër, i cili, për shkak të përmbajtjes, veçantive tematike dhe stilistike, duhet të propozohet dhe të shpërblehet me çmimin vjetor për poezi nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës, së cilës do t'i shkojnë, po për këtë çmim, shumë pak libra të tillë.

Çfarë duhet të dini tjetër gjë për Arifin dhe çfarë duhet të dini për këtë libër.

Duhet të dini, po deshët prova të tjera duhet të shkoni jashtë Kosovës që ta provoni, se malli për atdheun, për Kosovën, është më i madh kur je larg saj. Edhe reagimi më i fortë dhe më emocionues. Ky libër është produkt i



këtij malli. Dashuria e Arifit për Kosovën, edhe për atë vajzën e bërë grua ndërkohë, është në titullin metaforik dhe klisheatik të librit Si kripën të kam dashtë. Ma thotë mendja që ta them, se i kam dëgjuar këto dashuri të sinqerta të disa njerëzve para gjysmë shekulli nga njerëz që më nuk rrojnë. Po, paska ende këso dashuri të moçme dhe kështu të fortë, e cila përsëritet në shumë poezi të këtij libri edhe kur është fjala për gruan, edhe kur është fjala për shqiptarët, për vendlindjen, për Kosovën, për çdo punë të mirë që bën dikush kudo në një vend bote sepse, ky shkrimtar i qytetëruar dhe mbledhës i kulturës, është njëfarë kozmopoliti kulturor.

"Si kripën të kam dashtë" nuk është libër melodik. Në të nuk ka vargje të rregullta, po ka vargje të bardha. Nuk ka rima, po ka ritëm të rregullt dhe të qetë. Në të nuk ka tekste të këngëve, figura tingullore, po ka një vargmal figurash të mendimit të cilat lidhen dhe lidhin ngjarje shumë të vjetra, të vonshme dhe të reja nga jeta e autorit, të cilat kanë brenda vetes personalitete letrare, politike dhe veprimtarë të çështjes kombëtare si, për shembull, Ibrahim Rugovën, Jusuf Gërvallën, Sali Çekajn, kontributin e të cilëve e nderon teksa ua përmend mungesën e jashtëzakonshme fizike. Paralelisht me këta ecin kujtimet e autorit edhe për familjarët e tij, për të motrën dhe të vëllanë që i kanë ndërruar jetë.

Janë mes këtyre njerëzve edhe disa njerëz të tjerë, disa fatkeqësi të mëdha të tyre që i kanë parë vendet e tjera të botës e që kanë bërë shumë pak për ndaljen e vrasjeve. Në mesin e tyre është lufta qytetare në Aleppo, janë viktimat fëmijë të vrarë dhe të vdekur buzë detit sirian, për të cilët autori shprehet:

O Zot
ç'kuptim ka frymëmarrja ime
kur s'i ndihmon askujt
po po
ka dorëzim kolektiv të njerëzimit.

Tashmë jua bëra me dije se ky libër ka dhembje të përgjithshme, po më e theksuar është për Shqipërinë, për Luginën e Preshevës dhe për Çamërinë. Përpos për fatet e këtyre, autori shqetësohet sidomos për Kosovën dhe për disa territore të saj, për të ardhmen e Kullës së Zhlepit për të cilën shkruan baladë. Duke qenë larg Kosovës, pa pasur mundësi tjetër të protestimit, autori për këtë kullë ngre zërin në Gjermani. Shkruan vargje me përmbajtje historike, etnologjike, gjeografike, administrative. Jep kontribut historiko-letrar duke shpalosur kujtimet e vetat se Çakorri gjithmonë ka qenë i Kosovës. Por, meqë politikën e bën tjetërkush, ky zë proteste mbetet vetëm në letër. Dhe meqë ata nuk dëgjojnë reagimin e tij, Arifi proteston edhe kundër politikës së Kosovës, kundër zyrtarëve të Qeverisë, të cilët, pa as më të

voglin dyshim, meqë janë dhënë shumë pas interesave personale, kanë shpenzuar të gjithë energjinë atdhetare që kanë dhënë njëzet vjet më parë, me pushkë në krahë, për ta mbrojtur vendin. U vërsulet edhe njerëzve pa parime, ekspertëve të gjeometrisë që kanë ndërruar deklaratat ndër vite po për të njëjtën punë që kanë bërë vite më parë. Këtë degradim shoqëror s'mund ta kapërdijë Arifi fytyngushtë.

Së këndejmi, Arifi u reagon edhe atyre komandantëve të luftës që i kanë keqpërdoruar në paqe, për interesa personale dhe familjare, institucionet e Republikës së Kosovës, duke u pasuruar shpejt dhe duke e dëmtuar buxhetin e Kosovës shumë. Ata kanë bërë mirë që kanë luftuar dhe e kanë çliruar vendin nga Serbia, po ata s'kanë të drejtë as të veprojnë kundërligjshëm dhe as të na thonë, shkruan Arifi: "Ne ju çliruam, ne kemi të drejtë t'ju pallojmë!" Tekefundit, nëse bëjnë kështu si thonë, morali i tyre bie përtokë, paralelisht me respektin tonë për ta. Dhe, ne, Arifi dhe ju të tjerët që shkruani letërsi dhe lloje të tjera të shkrimeve ende me laps, do t'i mbrehni majat e tyre edhe më tutje që t'i denonconi fenomenet e këqija të tyre, me shpresë se një ditë do të marrin fund. Këtë militarizëm të shkruar me shkas herë në Hamburg e herë në Kosovë duhet ta lexoni sepse, ashtu sikurse në këtë libër, e mirë dhe e keqja, lufta dhe liria janë përbrenda jush. Kaq pata unë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	REAL BETIS - CADIZ	1	VALENCIA - REAL ZARAGOZA	1	UDINESE - PERUGIA	1
-------------------	--------------------	---	--------------------------	---	-------------------	---

Gjilani dhe Prishtina duan fitore në derbi

Gjilani, por edhe Prishtina, kanë paralajmëruar se sot (e shtunë) do t'i kërkojnë pikët maksimale nga ndeshja derbi e xhiros së dymbëdhjetë në IPKO Superligë. "Me kënaqësi e pres ndeshjen ndaj Prishtinës, e cila do të sjellë një rivalitet të madh, por edhe një atmosferë në tribunë. Ne do të angazhohemi maksimalisht që edhe në këtë ndeshje të arrijmë fitore", ka thënë Sadat Pajaziti, trajner i Gjilanit

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 TETOR - Trajneri Sadat Pajaziti beson se skuadra e Gjilanit mund ta mposhtë sot (e shtunë) Prishtinën në kuadër të javës së dymbëdhjetë në elitën e futbollit të Kosovës. Strategu nga Lugina e Preshevës beson se pas Feronikelit kokulur nga Gjilani do të rikthehet edhe skuadra kryeqytetase. "Normalisht se edhe ndeshja e radhës është mjaft e fortë, pasi përballimi me Prishtinën që, së bashku me Feronikelin, janë dy skuadrat më të forta në futbollin e Kosovës. Me kënaqësi e pres ndeshjen ndaj Prishtinës, e cila do të sjellë një rivalitet të madh, por edhe një atmosferë në tribunë. Ne do të angazhohemi maksimalisht që edhe në këtë ndeshje të arrijmë fitore dhe të vazhdojmë në këtë mënyrë deri në fund të sezonit vjeshtor, pastaj kemi kohë të organizohemi edhe më shumë si skuadër dhe, pse jo, të angazhohemi edhe ndonjë futbollist", ka thënë Pajaziti për "Epokën e re". Për ndeshjen që zhvillohet në Gjilan foli edhe mbrojtësi aktual i Prishtinës, Leotrim Bekteshi, i cili edicionin e kaluar ishte pjesë e Gjilanit. Bekteshi beson se skuadra "bardhekalte" do të dalë fituese nga kjo ndeshje derbi. "Shkojmë në udhëtim te skuadra që ka ekip shumë të mirë dhe ka pasur paraqitje të mira sivjet. Po ashtu, plus për të është edhe ambienti i mirë sportiv në shkallët e stadiumit. Por, kanë pasur shumë ndryshime në formacion dhe duke e njohur edhe fushën, sepse kemi luajtur gjatë atje, unë shpresoj shumë se do të rikthehem me rezultat pozitiv e që për ne do të thotë tri pikë të reja. E vlerësoj se do të jetë ndeshje shumë e vështirë, por edhe interesante. Por, kam besim te skuadra dhe te optimizmi ynë që do të vazhdojmë me serinë e paraqitjeve të mira", ka thënë Bekteshi për faqen zyrtare të klubit prishtinas. Skuadra e Gjilanit renditet në pozitën e pestë me 17 pikë, gjashtë pikë më pak se skuadra kryesuese në ligë. Prej njëmbëdhjetë ndeshjeve të zhvilluara, Gjilani ka pesë fitore, dy barazime dhe katër humbje. Në



anën tjetër, Prishtina pozicionohet e dyta me 21 pikë, por ka një ndeshje të pazhvilluar.

Flamurtari fiton pas shtatë ndeshjeve, Drita mezi e mposhti KEK-un

Fitore të premtën në kuadër të xhiros së dymbëdhjetë kanë shënuar Flamurtari, Drita dhe Ballkani ndaj Ferizajt, KEK-ut dhe Lirisë. Pesë gola janë shënuar në ndeshjen në mes të Ferizajt dhe Flamurtarit, kurse fituese doli skuadra nga kryeqyteti, Flamurtari, me rezultat 2-3. Florim Bërbatovci e shënoi golin e vetëm në pjesën e parë për rezultat 1-0, por mysafirët u rikthyen në pjesën e dytë dhe realizuan tre gola. Dy gola i realizoi Ilaz Zylfiu, kurse një tjetër e shtoi Egzon Krasniqi. Ndërsa vendësit e shënuan edhe një gol me anë të Mentor Mazrekajt, por në fund është dashur të pajtohet me humbje. Ndeshje jashtëzakonisht interesante u zhvillua në Obiliq, pasi fituesi i ndeshjes KEK-u - Drita u mësua vetëm në fund të ndeshjes (1-2). Betim Haxhimusa pas shtatë minutave lojë e solli skuadrën mysafire në epërsi 0-1, por KEK-u nuk u ndal dhe e barazoi rezultatit në minutën e dytë shtesë, dhe kur të gjithë pritën që skuadra do t'i ndajë pikët, Betim Haxhimusa del edhe një herë në

skenë duke realizuar golin e fitores për skuadrën kampione. Ballkani sërish ka dalë fitimtar ndaj Lirisë. Skuadra që tash drejtohet nga Sami Sermaxhaj e ka mposhtur Lirinë me rezultat 1-0, kurse golin e vetëm në këtë ndeshje e ka realizuar Borçe Manevski në minutën e 79. Skuadra nga Suhareka edhe në ndeshjen e parë të zhvilluar në Prizren kishte shënuar fitore me rezultat minimal 1-0.

IPKO SUPERLIGA

Ferizaj - Flamurtari	2-3
Ballkani - Liria	1-0
KEK-u - Drita	1-2

Të shtunën takohen:
Trepça '89 - Feronikeli
Gjilani - Prishtina
Drenica - Llapi
(Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 13:45)

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
Istogu - Dukagjini
Trepça - Onix
Të dielën takohen:
Kika - Fushë Kosova
Vllaznia - Arbëria
Vitia - Vëllaznimi
Besa - Ramiz Sadiku
Bashkimi (K) - Drenasi
Vushtrria - 2 Korriku

SHKURT

Kosovë - Gjermani zhvillohet të dielën

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll do të takohet me atë të Gjermanisë. Kjo ndeshje do të jetë e vlefshme për kualifikimet e Evropianit 2020 në hendboll. Ndeshja do të zhvillohet më 28 tetor në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Përfaqësuesja e Kosovës ka nevojë për përkrahje, kurse ndeshja fillon në orën 19:30.

U17-shtat pësojnë humbje nga Skocia

Përfaqësuesja e Kosovës U17 ka pësuar humbje në ndeshjen e parë të grupit 5 në kuadër të kualifikimeve për Evropianin 2019 që po mbahen në Qipro. Të përzgjedhurit e Besnik Kollarit janë mposhtur nga Skocia, me rezultat 2-1. Skocezët kaluan në epërsi në minutën e 28, me golin e Fiorinit, me të cilin rezultat edhe u mbyll pjesa e parë. Në pjesën e dytë djelmoshat tanë luajtën më mirë dhe në minutën e 71-të e barazuan rezultatit me golin e shënuar nga Edin Huseini. Megjithatë, skocezët reagueshan shpejt dhe pas gjashtë minutash e rikthyen epërsinë me golin e Winterit. Ndeshjen e radhës Kosova e zhvillon kundër Zvicrës më 29 tetor. Zvicranët në ndeshjen e parë e mposhtën Qipron 3-0.

Sadiku: Shqipëria më pengon të luaj për Kosovën

Pak kohë më parë u bë e famshme historia në mes të Shqipërisë, FIFA-s dhe Loret Sadikut dhe detyrimi i këtij të fundit që të luajë vetëm me ekipin kuqezi. Shkak për këtë detyrim është bërë ndryshimi i shpeshit të ekipeve kombëtare ku ka luajtur, duke qenë se është aktivizuar me 21-vjeçarët e Suedisë dhe më pas është grumbulluar me Shqipërinë. Në mungesë të minutave, ai u aktivizua në një takim në mes të Kosovës dhe Haitit. Kështu, Sadiku mund të luajë vetëm për Shqipërinë, por që duket diçka e pamundur duke qenë se nuk ka një marrëdhënie të mirë me stafin kuqezi dhe këtë e ka treguar edhe një herë në një intervistë për mediet turke. "Nuk e di çfarë mund të them në lidhje me këtë problem. Unë dhe ekipet kombëtare kemi disa probleme me FIFA-n, probleme të çuditshme. Zgjedha të luaja për ekipin kombëtar të Suedisë U21, po më pas vendosa të luaja për Shqipërinë. Në një moment historik për Kosovën, kur po luante një ndeshje miqësore para se të njihej nga FIFA dhe UEFA, i thashë trajnerit të Shqipërisë që të luaja te Kosova, por më tha se do të kisha probleme nëse largohesha", ka thënë Sadiku. "Gjithsesi, unë luajta me Kosovën, por sërish kisha probleme kur erdha te Shqipëria. Dokumentet e mia nuk ishin plotësuar ende, duke qenë se drejtuesit e Suedisë i kishin thënë FIFA-s që nuk mund të luajë për asnjë ekip tjetër. Nga ana tjetër, Kosova nuk do që të ketë probleme me Shqipërinë. Nuk e di se si do të shkojë kjo punë", u shpreh Sadiku.

Nesër "El Clasico" e parë pa Messin e Ronaldon

BARCELONË, 26 TETOR - Nesër (e diel) zhvillohet "El Clasico" në mes të Barcelonës dhe Real Madridit. Kjo ndeshje që vlerësohet si më e rëndësishmja në të gjitha ligat në botë, zhvillohet për herë të parë pas një dekade pa dy lojtarët më të

mirë në rruzull: Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon. Argjentinasi Messi u lëndua në fundjavën e kaluar në ndeshjen ndaj Sevillas (4-2), kurse portugezi Ronaldo në verë u transferua te Juventusit. Real Madridi do të arrijë në "El

Classico" e kësaj të diele me një "rekord" të shkëlqyer sa iu takon vizitave në "Camp Nou". Ndeshja e fundit, që të bardhët e humbën në transfertë kundër katalanasve, ishte me italianin Carlo Ancelotti në stol. "Los Blancos" u mundën

2-1 në një përplasje të La Ligas, e luajtur më 22 mars 2015. Në këtë duel Mathieu dhe Luis Suarez shënuan për Barcelonën, ndërsa Cristiano Ronaldo për "merengues". Kjo ndeshje zhvillohet në "Cam Nou" nga ora 17:15.



KOK-u mbështetë bursistët Olimpikë me 31 mijë euro

PRISHTINË, 26 TETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) do të mbështetë bursistët Olimpikë, të cilët janë duke ndjekur normën Olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Vendimi për 18 sportistët elitare është marrë në mbledhjen e 23-të të Bordit Ekzekutiv (BE) të KOK-ut. Në total, KOK-u nga buxheti i vet do të ndajë 31 mijë euro, të cilat do të ndahen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga BE për tri kategori. Buxheti i ndarë vlen vetëm për përgatitje dhe pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare si: kampionati evropian, botëror, apo edhe ndonjë garë tjetër që vlen për normë Olimpikë dhe të cilat organizohen deri në fund të këtij viti. Për kategorinë e parë që ndodhen: Majlinda Kelmendi (xhudo), Nora Gjakova (xhudo), Distria Krasniqi (xhudo), Herolind Nishevcu (karate) dhe Akil Gjakova (xhudo), KOK-u do të mbështesë dy përgatitje të sportistëve dhe një garë në vlerë totale prej 3 mijë euro për secilin sportistë. Për kategorinë e dytë, në të cilën përfshihen: Alvin Karaqi (karate), Orges Arifi (karate), Fortesa Orana (karate) dhe Loriana Kuka (xhudo), KOK-



u do të mbështesë një garë dhe një përgatitje në vlerë prej 2 mijë euro për sportistët. Ndërsa, në kategorinë e tretë, në të cilën ndodhen: Musa Hajdari (atletikë), Astrit Kryeziu (atletikë), Vijona Kryeziu (atletikë), Urata Rama (shenjëtari), Dasar Xhambazi (not), Flaka Pruthi (not), Atdhe Luzhnica (shigjetari), Edon Shala (mundje), Fortesa Orana (karate), Drilon Ibrahim (shenjëtari), do të ndahen nga 1 mijë euro, ndërsa sportistët do të vendosin nëse do t'i shpenzojnë në garë ndërkombëtare apo përgatitje. Kjo nuk është mbështetja e parë për bur-

sistët, pasi të njëjtit prej muajit shtator të vitit të kaluar, marrin paga prej 250 dollarë deri në 1 mijë dollarë nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe Komiteti Olimpik i Kosovës, ndërsa nga 100 Euro tjera nga komunat prej nga vijnë. Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, i ka ndaluar bursën boksieres Donjeta Sadiku, më 3 maj 2018, për shkak të mospajtimeve që ka Komiteti Olimpik Ndërkombëtar me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (AIBA).

LeBron Jamesi ua jep fitoren lakersave

LOS ANGELES, 26 TETOR - LeBron James arriti statistika dyshifrore në pikë, topa në tabelë dhe asiste, apo "triple-double" në fitoren e tij të parë në "Staples Center", teksa Los Angeles Lakers përmbysi rezultatin ndaj Denver Nuggetsit për ta fituar 128-111 mbrëmjen e së enjtes. Jamesi shënoi 28 pikë, dha 11 asistime dhe kapi 11 topa në tabelë, duke udhëhequr kështu kalifornianët që bënë gjithçka në fundin e takimit për t'i mposhtur nuggetsat, që deri më dje ishin të pamposhtur. Kjo ishte fitorja e dytë për Lakersat në dy ditë, duke e marrë disi veten pas nisjes me tri humbje radhazi të sezonit të ri. Një kontribut të veçantë dha edhe Lance Stephenson, i cili shënoi vetëm 12 pikë, por ajo që vlen është se këto ishin gjuajtje triplikëshe njëra pas tjetrës në perioidën e katërt, kur u shënuan edhe një rezultat i pjesshëm 15-2 për LA Lakers. Kyle Kuzma shënoi 22 pikë dhe JaVale McGee, 21 të tjera, statistika këto që i shtohen "triple-double"-it të James, e para me ekipin e



tij të ri. Jashtë ndeshjes, Kobe Bryant ishte i pranishëm në "Staples Center" për herë të parë që prej ardhjes së LeBron Jamesi, i cili udhëhoqi ekipin kur kishin mbetur edhe 3 minuta e 31 sekonda për t'u luajtur. Për Nuggetsat, Nikola Jokic shënoi 24 pikë, por ecuria më e mirë e tyre që prej sezonit 2009-2010 u ndal në Kaliforni. Në ndeshjet e tjera, Damian Lillard shënoi 41 pikë, teksa Portland Blazersi fitoi

128-114 me Orlando Magicun. Në Oklahoma, Jayson Tatum shënoi 24 pikë dhe Boston Celticsi përmbysi diferencën 16-pikëshe pas pushimit për të mposhtur City Thunderin 101-95.

REZULTATET

Detroit - Cleveland	110-103
Orlando - Portland	114-128
Oklahoma - Boston	95-101
Lakers - Denver	121-114

SHKURT

Përfaqësuesja e femrave, dy miqësore në Turqi

Krahës aktivitetit të Përfaqësueses në konkurrencën e meshkujve, edhe Përfaqësuesja A - femrat - do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore kundër Kombëtares së Ukrainës. Siç bën të ditur Artan Govori, drejtor për marrëdhënie me jashtë dhe i ekupeve përfaqësuese, tashmë ekziston marrëveshja edhe me Federatën e Ukrainës që në Turqi të zhvillohen dy ndeshje më 9 dhe 12 nëntor. Përgatitja për këto ndeshje ka filluar dhe çdo gjë po shkon sipas programit të paraparë. Kjo është e mirëseardhur për Përfaqësuesen e femrave për ta parë formën e futbollisteve sepse nga ndeshjet me Maqedoninë nuk kanë pasur një tjetër grumbullim.

Ter Stegen: E kam menduar largimin nga Barça

Portieri i Gjermanisë, Marc-Andre Ter Stegen, ka bërë me dije se kishte çaste kur e kishte menduar largimin nga Barcelona. "Si një njeri i cili dëshiron të luaj çdo ndeshje, rotacioni për mua ishte një situatë shumë e komplikuar. Gara me Bravon nuk ishte e lehtë dhe nuk mund ta mohoj se në disa çaste e merrja në konsideratë largimin", ka thënë Ter Stegen. "Më kishin thënë këtu për disa vite që klubi ka besim në mua, por gjërat në realitet dukeshin ndryshe dhe Bravo qartë ishte një opsion i preferuar i tyre", ka shtuar Ter Stegen.

Cavani po mendon rikthimin te Napoli

Edinson Cavani dhe Napoli kanë mbetur shumë të lidhur. Këtë e konfirmoi përfaqësi me presidentin e të kaltërve, Aurelio De Laurentis, përpara ndeshjes si dhe vizita e fotot në dhomat e zhveshjeve të italianëve, pas barazimit 2-2 në Paris. Sulmuesi uruguaian i PSG-së shpeshherë është përfolur se mund të bëjë një rikthim të bujshëm në "San Paolo" dhe këtë e ka konfirmuar edhe avokati dhe mik i tij, Xhenaro Familjeti. "Edinson adhuron Napolin, jo vetëm skuadrën, por edhe qytetin, dhe përfaqësi me De Laurentisin e konfirmon këtë. Vetë Edinson nuk e ka fshehur kurrë mundësinë e një rikthimi në këtë skuadër, por sigurisht që më pas janë në lojë pretendime personale ekonomike të tij që duhet të bisedohen. Prandaj, ideja që tifozët e Napolit ta shohin sërish Cavanin me bluzën e tyre mbetet shumë e hapur".

Immobile: Duam hakmarrje ndaj Interit

Sulmuesi Ciro Immobile është i kënaqur me fitoren e Lazios ndaj Marseillet në Evropa Ligë. Sipas tij, kjo fitore do t'i japë moral skuadrës së Lazios për ndeshjen ndaj Interit në Serinë A. "Arritëm një fitore të bukur kundër Marseillet dhe nuk ishte e thjeshtë të bënim këtë performancë. Luajtëm një ndeshje të madhe dhe arritëm tri pikë të rëndësishme për renditjen e grupit. Jam kënaq për 100 ndeshjet me Lazio, goli do të ishte qershia mbi tortë, por jam i kënaqur me atë që po bëj. Lazio është familja ime dhe ndihem si në shtëpi. Tani duhet të fillojmë të mendojmë menjëherë për Interin. Duam të bëjmë një ndeshje të mirë dhe të hakmerremi për sezonin e kaluar. Jemi të karikuar. Kjo fitore na jep moral për t'u përballur me zikaltrit", ka thënë Immobile.

Sanchezi dëshiron transferimin në PSG

Sulmuesi i Manchester Unitedit, Alexis Sanchez, raportohet se me çdo kusht dëshiron transferimin te Paris Saint-Germaini. Kiliani që u transferua tek Unitedi nga Arsenalin në muajin janar ka realizuar vetëm katër gola në 26 paraqitje për "Djajtë e Kuq". 29-vjeçari në ndeshjet e fundit nuk është ftuar në formacion dhe, sipas gazetës britanike, "The Mirror" ai është duke kërkuar një largim nga "Old Trafford" gjatë muajit janar të vitit 2019. PSG-ja ka shprehur interesim për të dhe Sanchezi është i vendosur të kalojë te kampioni francez që do të mund ta financonte pagën javore prej 500 mijë funteve.



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIÇNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE

Departamenti i Administratës

Nr. 1202
Datë: 26.10.2018
Ferizaj

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës Nr. 03/L- 212; UA Nr. 07/2017 të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, nenit 2 të Rregullores për Punë të QKMF-së, neni 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale, UD i Drejtorit të QKMF-së në Ferizaj publikon këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

1. Një Specialist të Mjekësisë Familjare, Specializant të Mjekësisë Familjare ose Mjek të Përgjithshëm

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Bën edukimin dhe promovimin shëndetësor,
- Përcjell zhvillimet në mjekësi përmes qasjes për aftësim të vazhduar profesional,
- Është në mbikëqyrje dhe përcjellje të vazhduar të familjes,
- Bën vizitat shtëpiake të pacientëve të sëmurë kronikë,
- Mbikëqyr dhe preferon marrjen e vaksinave të rregullta edhe në raste të jashtëzakonshme,
- Mban evidencë për të gjithë pacientët e tij dhe kujdeset për menaxhimin e sëmundjeve infektive dhe kronike, mban fshehtësinë e sëmundjes së pacientit,
- Evidenton dhe paraqet rastet e sëmundjeve infektive sipas rregullave të Institutit Publik,
- Synon të kuptojë sëmundjet duke nisur nga rrethanat shoqërore, familjare dhe personale,
- Bën diagnostifikimin dhe përcakton terapinë,
- Mjeku familjar punon si ekip me infermierët dhe profesionistët e tjerë,
- Bashkëpunon me kolegët dhe diskuton për probleme mjekësore,
- Bashkëpunon ngushtë me infermierët e Mjekësisë Familjare,
- Mban kujdestarinë sipas orarit të caktuar,
- Për punën që kryen i jep përgjegjësi shefit të QMF - së etj.

Kualifikimi: Specialist i Mjekësisë Familjare, Specializant i Mjekësisë Familjare ose Mjek i Përgjithshëm

Licenca e punës

Paga: Për Specialist të Mjekësisë Familjare 659 €, Specializant dhe Mjek të Përgjithshëm 565 €.

Periudha kontraktuese deri sa të kthehet punëtori nga posti politik .

Lokacioni i punës është kujdestaria e natës në Shërbimin Emergjent Primar.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet:

- Të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës,
- Të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale dhe të mos gjenden aktualisht nën hetime,
- Të jenë të aftë për të bartur përgjegjësitë e pozitës me orar të plotë pa kufizime dhe pa pengesa ligjore,
- Të posedojnë shkathtësi dhe aftësi profesionale për të punuar në mënyrë të suksesshme në një shoqëri multietnike,
- Të njohin punën me kompjuter.

Bashkë me fletëaplikacionin e plotësuar kandidatët duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Dëshminë për shkollimin e mbaruar,
- Programin me informacion për vendin e punës që konkurron,
- Dokumentin e identifikimit,
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (për kandidatët e pranuar),
- Certifikatën që nuk është nën hetime.

Institucioni ynë shëndetësor është në shërbim të gjithë popullatës së Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga meshkujt dhe femrat nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë deri më 12.11.2018, fletëaplikacionet merren në Zyrën e Administratës në QKMF në Ferizaj. Kandidatët me dokumente të pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të hyjnë në listën e ngushtë për t'u intervistuar. Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Zyrën e Sektorit të Administratës në këtë numër të telefonit 0290-320-871.



UD i Drejtorit:
Dr. Asllan Bajrami



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIÇNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE

Departman za administraciju

Br. 1202
Datum: 26.10.2018
Uroševac

Na osnovu člana 8 Zakona o radu Republike Kosova Br. 03 / L-212, AU Br. 07/2017 Ministarstva rada i socijalne zaštite, član 2 Uredbe o Radu GCPM-e, član 5 Sektorski Kolektivni Ugovor, VD Direktora GCPM-e u Uroševcu objavljuje:

KONKURS

Za popunjavanje radnih mesta

- Jedan Specijalista porodične medicine, Specijalizant porodične medicine ili Lekar opšte medicine

Opis radnih zadataka:

- Vrsi vaspitanje i promociju zdravlja,
- Prati medicinski razvoj putem pristupa stalnom stručnom usavršavanju,
- U kontinuiranom je nadzoru i praćenju porodice,
- Obavlja kućne posete hronično bolesnim pacijentima,
- Nadgleda i preferira primanje redovnih i vanrednih vakcina
- Vodi evidenciju za sve svoje pacijente i brine se za upravljanje infektivnim i hroničnim bolestima, čuva tajnost bolesti pacijenta
- Evidentira i prijavljuje slučajeve zaraznih bolesti prema pravilima Javnog instituta,
- Namerava da shvati bolesti, počevši od društvenih, porodičnih i ličnih okolnosti,
- Obavlja dijagnostiku i određuje terapiju,
- Porodični lekar radi kao tim sa medicinskim sestrama i drugim stručnjacima,
- Saraduje sa kolegama i razmatra medicinske probleme,
- Blisko saraduje sa medicinskim osobljem porodične medicine,
- Održava dežurstvo prema fiksnom rasporedu,
- Za rad koji obavlja odgovoran je šefu CPM-a, itd.

Kvalifikacija: specijalista porodične medicine, specijalizant porodične medicine ili opšti lekar.

Licenca rada

Plata: Za Specijalistu porodične medicine 659 €, Specijalizant porodične medicine i Opšti lekar 565 €.

Ugovorni period dok se vrati radnik sa političkog položaja.

Lokacija posla je Noćno dežurstvo u Primarnoj službi za hitne slučajeve.

Kandidati koji se prijavljuju trebaju:


- Da budu državljanin Republike Kosova
- Da nisu osuđeni za krivična dela i trenutno nisu pod istragom
- Da budu sposobni da snose punu odgovornost položaja bez ikakvih ograničenja i pravnih prepreka
- Da poseduju veštine i profesionalne sposobnosti za uspešno delovanje u multietničkom društvu
- Da poznaju rad sa kompjuterom.

Pored popunjenog obrazca za prijavu, kandidati moraju dostaviti i sledeće dokumente:

- Dokaz o završenom obrazovanju
- Informativni program za radno mesto za koje se prijavljuje
- Identifikacioni dokument
- Sertifikat o zdravstvenom stanju (za primljene kandidate)
- Sertifikat da nije pod istragom.

Naša zdravstvena ustanova je u službi celokupnog stanovništva Kosova i pozdravlja prijave muškaraca i žena iz svih zajednica Republike Kosovo.

Zainteresovani kandidati mogu se prijaviti do 12.11.2018, obrazce za prijavljivanje mogu dobiti u Kancelariji administracije GCPM-e u Uroševcu. Kandidati sa nekompletiranim dokumentima i nakon roka neće ući u užu listu za intervjuisanje. Za sve dodatne informacije možete se obratiti Službi Sektora Administracije na ovom broju 0290-320-871.



VD Direktora:
Dr. Asllan Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë* shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Financa dhe shërbime të përgjithshme
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i buxhetit (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 26.10.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bashkëpunon me programet, departamentet e Ministrisë gjatë procesit të planifikimit të buxhetit për vitin vijues dhe për tri vitet e ardhshme;
- Bashkëpunon me programet, departamentet dhe institucionet tjera të sektorit të arsimit lidhur me planifikimin afatmesëm të buxhetit;
- Grumbullon informatat dhe kërkesat buxhetore të programeve, departamenteve të Ministrisë gjatë procesit të planifikimit të buxhetit të Ministrisë;
- Përgadit planin e realizimit të buxhetit, sipas muajve për programet dhe departamentet e Ministrisë;
- Në bashkëpunim me programet, departamentet e Ministrisë përgadit planin e realizimit të buxhetit sipas muajve;
- Monitoron realizimin e buxhetit të aprovuar për programet, departamentet e Ministrisë dhe analizon realizimin e buxhetit;
- Përgadit të dhënat financiare, informatat për arritjen e objektivave të parapara me buxhet;
- Përgadit raporte lidhur me buxhetin sipas kërkesave të parashtruara nga mbikqyrësi;

Kualifikimet

1. Diplomë universitare drejtimi ekonomi, financa, biznes apo të ngjajshme;
2. 1 vite përvojë pune në lëminë përkatëse;
3. Njohuri të të mira në lidhje me buxhetin dhe parimet buxhetore
4. Njohja e punës me kompjuter të programeve: Word, Excel, Power Point, etj.
5. Aftësia e të shprehurit në gjuhën e komuniteteve dhe Angleze
6. Zotësia në komunikim, shprehje, sqarim në dhënjën e informatave të ndryshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendrike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit **31.10.2018.**

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në web faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije* vrši:

Konkursa za "Sporazum o posebnim uslugama "

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Divizija: Finansija i javne usluge
Paga bruto: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Službenik za budžet (1 radno mesto)

Vreme trajanje ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum:** 26.10.2018

Radni zadaci i odgovornosti:

- Saraduje sa programima, departamentima Ministarstva u procesu planiranja budžeta za narednu godinu i za naredne tri godine;
- Saraduje sa programima, departamentima i drugim institucijama sektora obrazovanja u vezi srednjoročno planiranje budžeta;
- Prikuplja informacije i budžetske zahteve programa, odepartamenta Ministarstva tokom procesa planiranja budžeta Ministarstva;
- Priprema plan realizacije budžeta, prema mesecima za programe i departamente Ministarstva;
- U saradnji sa programima, departamentima Ministarstva pripremaju plan realizacije budžeta po mjesecima;
- Prati implementaciju odobrenog budžeta za programe, departamente Ministarstva i analizira realizaciju budžeta;
- Priprema finansijske podatke, informacije o postizanju budžetskih ciljeva predviđeni budžetom;
- Pripremi izvještaje u vezi budžet u skladu sa zahtevima koje je podneo nadzornik;
- Obavlja i druge poslove koje mu delegira njegov nadzornik;

Kvalifikacije

1. Univerzitetska diploma smer ekonomija, finansije, biznis ili slično;
2. 1 godinu radnog iskustva u relevantnoj oblasti;
3. Dobra poznavanja u vezi budžeti budžetskih principa
4. Poznavanje rad sa računarskim programima: Word, Excel, Power Point itd.
5. Sposobnost govora na jezicima zajednica i na engleskom
6. Ovladavanje u komunikaciji, izražavanju, pojašnjenju pri pružanju različitih informacija.

Uslovi učešće na konkurs:

Pravo na podnošenje aplikacije imaju svi punoletni građani građani Republike Kosova koji imaju sposobnost delovanja, da imaju potrebnu školsku spremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje obaveza i ona lica koja imaju fizičku sposobnost koja se zahteva za relevantan položaj.

Datum završetka konkursa: Konkurs je otvoren 5 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dan završetka konkursa je **31.10.2018.**

Kandidati aplikacija (obrazac za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, kancelariji arhive u kojoj će kasnije popunjene aplikacije predati.

Uz aplikaciju mora biti priložena: Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikovanju, kao i ostala dokumentacije potrebna shodno konkursu.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka konkursa neće biti primljeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na uvoj listi biće kontaktirani.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES
AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Arkiv në QRTK Prishtinë
Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prishtinë
Kategoria funksionale : Koeficienti: 6
Numri i referencës: 50/2018
I përgjigjet: Drejtorit të QRTK Prishtinë
Vendi: Prishtinë
Lloji i kontratës: "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)
Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë Prishtinë, kryen keto detyra dhe përgjegjësi:

1. Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;
2. Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
3. Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
4. Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
5. Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
6. Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
7. Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postes, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
2. Shkathhtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
3. Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
4. Shkathhtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);
5. Arsimitim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku 1 (nje) vit përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur tete (8) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: **03.11.2018**

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Adresa: Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921, (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES
AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu, br. 03/L-212, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja pri Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo za Kulturu, Omladinu i Sport objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za Ahivu u RCKB-Priština
Institucija: Rajonalni Centar za Kulturnu Baštinu Priština
Funksionalja kategorija: Koeficientat: 6
Broj referencije: 50/2018
Nadzornik: Direktor RCKB-a Priština
Mesto: Priština
Vrsta Ugovora: „Sporazum o posebnim uslugama“ (Vremenski rok 6 meseci)
Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora RCKB-a Priština, ispunjava sledeće dužnosti i odgovornosti:

1. Prima dokumenta i predmete za arhiviranje i brine o njihovom arhiviranju, u podudarnosti sa zakonskim procedurama;
2. Brine o sistemiranju i ažurnom održavanju arhivskih predmeta kao i predlaže potrebno uputstvo za funkcionisanje arhiva;
3. Održava poseban arkiv za specifične detaljne slučajeve u čuva nedodirljivost informacija;
4. Brine o redovno selekcionisanju arhivskog predmeta;
5. Održava redovne kontakte sa institucijama arhiva Kosova, sa ciljem predaje predmeta kompetentnom arhivu, nakon isteka roka;
6. Preduzima i ostale delatnosti u cilju što boljeg funkcionisanja zakona o arhivskim predmetima Kosova;
7. Koordinira rad sa službenikom koji se zauzima raspodelom poste i spisa, unitar i van institucije;
8. Izvršava i ostale zadatke u podudarnosti sa zakonom i pravilnicima, koji se na razložan način mogu zahtevati od nadzornika, s vremena na vreme.

Potrebno obrazovanje, iskustvo, veštine i lične karakteristike:

1. Sposobnost za sprovođenje administrativnih procedura i uputstava za izvršavanje radnih zadataka;
2. Sposobnost u komuniciranju, obuhvatajući sposobnost za interpretiranje informacija, davaje uputstava i praćenje informacija kod ostalih;
3. Sposobnost za koordinaciju i nadziranje poslova osoblja na administrativnom i tehničkom nivou;
4. Sposobnost na kompjuteru u aplikaciji programa (Word, Excel);
5. Srednje školsko obrazovanje, dotično treniranje i najmanje jedna (1) godina radnog iskustva iz dotične tehničke ili administrativne.

Postupci prijave: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Rok trajanje imenovanja: Imenovanje ima fiksni rok trajanje.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren osam (8) dana od dana objavljivanja.

Poslednji datum prijave je: **03.11.2018**

Aplikacije koje se šalju poštom, poštanskom markom, u poslednjem danu oglasa smatraju se važećim.

Podnošenje prijave: Prijava se predaje pri Uredu broj 27, Ministarstva kulture, omladine i sporta, Trg „Majke Tereze“ Rr. 44. Za dodatne informacije obratite nam se na telefonskom broju: 038211449 (ili na <http://www.mkrs-ks.org/>).



NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Ne bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Vendimit të Bordit të Drejtorëve të TK. sh.a të datës 25.10.2018, vazhdohet edhe për pesë (5) ditë të tjera afati i konkursit i shpallur me dt. 14.09.2018, për shkak të inkurajimit të aplikantëve nga komunitetet dhe balancimit të aplikacioneve nga aspekti gjinor. Konkursi është i hapur pesë (5) ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të korporatës dhe mjetet e informimit publik, për pozitat:

- Titulli pozitës:**
1. Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit (1 ekzekutues)
 2. Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar i Korporatës (1 ekzekutues)
 3. Zyrtar i Auditimit të Brendshëm (1 ekzekutues)
 4. Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv (2 ekzekutues)

Ndërmarrja: Telekom i Kosovës sh.a.

Vendi: Prishtinë

PËRSHKRIMI I NDËRMARRJES

Telekom i Kosovës sh.a (TK SH.A.) është ndërmarrje publike e licencuar për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të telekomunikacionit, që të ardhurat më të mëdha të TK-së gjenerohen nga aktivitetet e Telefonisë Mobile VALA dhe se TK, vazhdon të konkurroj në një treg të hapur dhe konkurrues, duke sjellur inovacione dhe risi në tregun e telekomunikacionit. TK është në kërkim të zyrtareve kryesor të korporatës me kualifikim, me integritet të njohur dhe përvojë të nevojshme profesionale që do të udhëheqin korporatën në përputhje me parimet e njohura për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike dhe të vazhdojnë zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve në një ambient konkurrues.

Vendi i Punës: Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Duke i raportuar Bordit të Drejtorëve (BtëD), Zyrtari Kryesor i Financave dhe Thesarit është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të Financave dhe Thesarit në TK.

Detyrat / përgjegjësit kryesore:

- Udhëheqë e evidencat lidhur me mjetet financiare të Korporatës dhe gjendjen e Thesarit;
- Themelon dhe shqyrton kontrollin e brendshëm financiar, duke përfshirë edhe blerjet, faturat e parave kesh dhe asetet fikse;
- Monitoron llogaritë fitimprurëse dhe koordinon pagesat e faturave dhe blerjeve të posaçme;
- Shqyrton shpenzimet e punonjësve për të siguruar pajtueshmërinë me politikën e Korporatës dhe buxhetin para pagimit;
- Përgatit dokumentet e Korporatës për auditimin në fund të vitit dhe shërben si një ndërlidhës për auditorët;
- Shqyrton, bënë marrëveshje për prokurimin, dhe mirëmban të gjitha politikën e sigurimit të lidhura me biznesin;
- Përcakton dhe harton buxhetin e Korporatës;
- Zhvillon dhe implementon strategjitë financiare afat mesme dhe afat gjate për të siguruar menaxhim dhe siguri të fondeve në mënyrën më profitabile;
- Inicion ndryshime dhe plane për zhvillimin e stafit në departamentin e financave në pajtim me praktikën moderne ekzistuese në këtë fushë;
- Zhvillon procedurat për të kontrolluar dhe planifikuar qarkullimin e parave të institucioneve ndërkombëtare të trafikut;
- Siguron që TK SH.A është në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret relevante në këtë fushë.

Kualifikimi, përvoja dhe të tjera:

- Te ketë diplomë universitare -Fakulteti Ekonomik;
- Te ketë experience në fushën e financave dhe kontabilitetit;
- Së paku 5 vite përvojë në menaxhim të financave në nivel lartë të menaxhmentit;
- Përvojë rajonale dhe të lidhur me industrinë do të ishte përparësi; dalluar;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve me kapacitet për tu përqendruar në simptomat në zhvillimin e zgjidhjeve afat gjata;
- Njohuri të gjerë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS), menaxhim të financave dhe qarkullimit të parave
- Kapacitet për të trajnuar dhe zhvilluar stafin e financave;
- Aftësi të forta bindëse/ndër personale;
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.

Vendi i punës: Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar i Korporatës

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës përkujdeset për ligjshmërinë e fushëveprimit të BtëD dhe është përgjegjës për menaxhimin e çështjeve administrative të Bordit të Drejtorëve TK sh.a.

Detyrat / përgjegjësit kryesore:

- Mirëmban regjistrin e aksionarëve të Korporatës dhe siguron që ndryshimet në regjistrin e aksioneve të kryhen në përputhje me Ligjet në fuqi dhe aktet interne të korporatës;
- Siguron të dhënat e nevojshme, mirëmban dokumentet dhe procesverbalin nga takimet e Bordit të Drejtorëve të TK-së;
- Përgatit dhe koordinon të gjitha aktivitetet rreth mbledhjeve të rregullta dhe jashtëzakonshme të BtëD;
- Siguron shënime, raportet dhe prezantimet e duhura për Takimin të Përgjithshëm të aksionarëve dhe të takimeve të Bordit të Drejtorëve;
- Vepron si agjent i Korporatës për pranimin e njoftimeve;
- Përkujdeset në parim për bazën legale të vendimeve të korporatës;
- Planifikon, drejton dhe koordinon aktivitetet operacionale të nivelit më të lartë të menaxhmentit në PTK;
- Konsultohet me Kryeshefin Ekzekutiv (KE) të TK-së dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve për themelimin e politikave të biznes dhe planeve të Njësive të Biznesit dhe Njësive Qendrore;
- Drejton aktivitetet e shërbimeve të menaxhmentit për të planifikuar procedurat;
- Siguron qarkullimin e informatave nga BiD për Menaxhmentin Ekzekutiv, dhe raporton përmes KE në BeD për veprimet e ndërmarrja;
- Përkujdeset për formën e unifikuar të akteve komunikuese të brendshme dhe jashtë korporatës;
- Mbikëqyr dhe udhëzon kompetentet e përmbajtjes së web faqes së korporatës.

Kualifikimi, përvoja dhe të tjera:

